



HORIZONTAL FACILITY FOR THE WESTERN BALKANS AND TURKEY 2019-2022

FOR YOUR RIGHTS:
TOWARDS
EUROPEAN STANDARDS

INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË II

*

“PROMOVIMI I DIVERSITETIT DHE BARAZISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR”

“PROMOVIMI I DIVERSITETIT DHE BARAZISË NË SHQIPËRI”

*

Studim krahasimor:

“Forcimi i organeve të barazisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor në fushën e gjuhës së urrejtjes”

Raporti i vendit: Shqipëri

Hartuar nga Aida Gugu Bushati

Tiranë, Maj 2020

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

© Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Licencuar për Bashkimin Evropian sipas kushteve të caktuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, të riprodhohet apo të transmetohet, në asnjë lloj forme dhe me asnjë lloj mjete, elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin dhe çdo lloj sistemi për ruajtjen apo gjetjen e informacionit pa lejen paraprake me shkrim të Drejtorisë së Komunikimit (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Ky dokument është hartuar duke përdorur fondet e Programit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të Bashkimit Evropian apo Këshillit të Evropës.

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Përmbajtjes	3
0 Përmbledhja ekzekutive.....	5
1 Hyrje	6
2 Kuadri ligjor mbi luftimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes.....	7
2.1 Dispozitat kushtetuese dhe ligjore lidhur me gjuhën e urrejtjes (online)	7
2.2 Jurisprudenca	9
2.3 Mekanizmat e vetërregullimit dhe kodet e sjelljes.....	10
2.4 Praktika e mirë	10
3 Kuadri Institucional për Luftimin dhe Parandalimin e Gjuhës së Urrejtjes përtej Organeve të Barazisë.....	11
3.1 Rolet dhe Kompetencat e Institucioneve dhe Organizatave të tjera (përtej Organeve të Barazisë)	11
3.2 Roli i gjykatave	11
3.3 Roli i policisë dhe avokatëve të shtetit	12
3.4 Mekanizmat e vetërregullimit të lidhur me median	13
3.5 Faktorët promovues dhe pengues për qasje në drejtësi dhe ndihmë ndaj viktimave	14
4 Roli i organeve të barazisë në luftimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes në praktikë	14
4.1 Roli dhe kompetencat e organit/organeve të barazisë	15
4.2 Roli dhe mandati i institucioneve të tjera të pavarura (si institucionet e Avokatit të Popullit).....	15
4.3 Zbatimi i kompetencave (ligjore) nga organet e barazisë.....	16
4.4 Strategjitë zyrtare dhe jozyrtare të organeve të barazisë	17
4.5 Praktika e mirë	17
5 Jurisprudenca mbi gjuhën e urrejtjes.....	17
5.1 Rastet e gjuhës së urrejtjes (online) të trajtuara nga organet e barazisë.....	17
5.2 Organet e barazisë dhe gjykatat	18
5.3 Raste të ndërmarra “ex-officio” nga organet e barazisë	19
5.4 Gjuha e urrejtjes (online) dhe baza e të dhënave e çështjeve të organeve të barazisë	19
5.5 Nevojat e organeve të barazisë për të trajtuar (më shumë) raste/përmirësimin e trajtimit të çështjeve	19
5.6 Praktika e mirë	19
6 Identifikim i bashkëpunimit mbi rastet ndërmjet organeve të barazisë dhe palëve të interesuara.....	20
6.1 Kontakti i parë për viktimat e gjuhës së urrejtjes (online).....	20
6.2 Transmetimi i rasteve nga organet e barazisë ndaj institucioneve të tjera.....	20
6.3 Bashkëpunimi mes organeve të barazisë dhe Avokatit të Popullit.....	20

6.4	Bashkëpunimi i organeve të barazisë dhe OSHC-ve	20
6.5	Nevojat e organeve të barazisë për të krijuar/përmirësuar bashkëpunimin me palët e interesuara përkatëse	21
6.6	Praktika e mirë	21
7	Roli i organeve të barazisë në ndërgjegjësimin dhe promovimin e informacionit rreth gjuhës së urrejtjes	22
7.1	Aktivitetet e organeve të barazisë për rritjen e ndërgjegjësimit rreth gjuhës së urrejtjes (online)	22
7.2	Nevojat e organeve të barazisë për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit ndaj gjuhës së urrejtjes (online).....	22
7.3	Raporti vjetor i organeve të barazisë dhe gjuha e urrejtjes (online)	23
7.4	Aktivitete promovuese dhe të marrëdhënieve me publikun të organeve të barazisë lidhur me gjuhën e urrejtjes (online).....	23
7.5	Nevojat e organeve të barazisë për zhvillimin (e mëtejshëm) të një Strategjie Komunikimi mbi Gjuhën e Urrejtjes (online)	23
7.6	Praktika e mirë	23
8	Kërkime dhe sondazhe mbi gjuhën e urrejtjes	24
8.1	Përfshirja e organeve të barazisë në kryerjen e studimeve dhe/ose sondazheve	24
8.2	Nevojat e organeve të barazisë për të zbatuar në mënyrë më efektive dhe për të përhapur rezultatet e studimeve/sondazheve	24
8.3	Praktika e mirë	24
9	Përfshirja dhe aktivitetet e bashkëpunimit mbi luftimin e gjuhës së urrejtjes.....	24
9.1	Përfshirja e organeve të barazisë në projekte për luftimin e gjuhës së urrejtjes (online) dhe nevoja të mëtejshme	25
9.2	Bashkëpunimi Dypalësh dhe Ndërtimi i Rrjeteve Rajonale/Ndërkombëtare të Organeve të Barazisë dhe Nevojat e tyre të ardhshme.....	26
9.3	Praktika e mirë	26
10	Përfundime dhe rekomandime	26
11	Referenca	27
	Shtojca 1 – Model për Shembuj të Praktikave më të Mira	29
	Tabela 1:	29
	Tabela 2:	30
	Tabela 3:	31

Në të gjithë botën, përdorimi i gjuhës së urrejtjes është në rritje, dhe gjuha e përjashtimit dhe diskriminimit ka depërtuar në mbulimin mediatik, në platforma online dhe në deklaratave publike. Gjuha e urrejtjes dobëson dhe shkatërron komunitetet, dhe kur lihet e pakontrolluar ajo mund të çojë në dhunë dhe madje të hapë terrenin e genocidit. Nga ana tjetër liria e shprehjes përbën një të drejtë themelore të rëndësishme dhe të domosdoshme për çdo shoqëri demokratike. Megjithatë, komuniteti ndërkombëtar ka rënë dakord gjithashtu për disa kufizime, sikundër për gjuhën e cila advokon “urrejtjen kombëtare, racore apo fetare” dhe “përbën nxitje ndaj diskriminimit, armiqësisë dhe dhunës”. Prandaj, është shumë e rëndësishme që qeveritë të krijojnë një kuadër ligjor solid për gjuhën e urrejtjes i cili vendos përgjegjësitë mbi autorët, mbështet dinjitetin njerëzor dhe mbron grupet e marginalizuara, ndërsa ruan balancën e së drejtës për lirinë e shprehjes.

Megjithëse nuk ka një përkufizim ligjor mbi gjuhën e urrejtjes, ajo përkufizohet përgjithësisht si avokimi, promovimi apo nxitja e çdo forme denigrimi apo urrejtjeje të një personi apo grupi personash mbi baza racore, ngjyre, kombësie, gjinie apo besimi.

Shqipëria si gjithë anëtarët e Këshillit të Evropës, është pjesë e “Lëvizjes kundër Urrejtjes” që prej vitit 2014. Krimet e urrejtjes janë përfshirë si pjesë e veprave penale në Kodin Penal dhe njëherazi disa veprime janë ndërmarrë për t’u përballur me këtë çështje përtej rrafshit penal. Kuadri ligjor shqiptar për luftimin e gjuhës së urrejtjes është konsideruar në përputhje me shumë instrumente evropiane dhe ndërkombëtare. Megjithatë, për shkak të rritjes së fenomenit në daljet mediatike, kryesisht në ato online, janë ndërmarrë disa veprime për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe për të përfshirë një përkufizim ligjor të gjuhës së urrejtjes. Paralelisht, organet e barazisë dhe organizatat e shoqërisë civile janë angazhuar së fundmi në veprime për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe angazhimi i tyre në luftimin e gjuhës së urrejtjes është shtuar.

Pavarësisht gjithë përpjekjeve të kryera deri më sot, analiza sugjeron se duhet përdorur një qasje gjithëpërfshirëse me masa konkrete dhe të qëndrueshme. Ka një mbulim të gjerë të fenomeneve në kryeqytet, ndërsa qytetet dhe rrethet e tjera janë lënë jashtë fushëveprimit. Institucionet dakordësohen mbi një qasje që ngrihet nga poshtë-lart, duke nisur nga arsimit dhe përmirësimi i programeve mësimore në shkolla, deri në ndëshkim të atyre që keqpërdorin pushtetin publik duke përdorur gjuhën e urrejtjes.

1 Hyrje

Në shoqëritë multikulturore, të cilat karakterizohen nga shumëllojshmëri traditash, fesh dhe stilesh në kryerjen e jetesës, ndonjëherë është e nevojshme të pajtohet e drejta për lirinë e shprehjes me të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, ose të drejtën për të qenë i lirë nga diskriminimi. Arritja e pajtimit është një ekuilibër i hollë, pasi këto të drejta përbëjnë shtyllat themelore të një "shoqërie demokratike". Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) përmban një jurisprudencë të pasur mbi linjën e hollë midis lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes.

Sidoqoftë, vështirësitë mbesin tek fakti se nuk ekziston një përkufizim standard i gjuhës së urrejtjes në legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe as ka përkufizime të qarta në legjislacionin kombëtar. Gjykatat Kombëtare duhet t'i trajtojnë më së shumti çështjet e gjuhës së urrejtjes si kufizime të lirisë së shprehjes, një e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe e përcaktuar qartë me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Disa përpjekje janë kryer për të përkufizuar gjuhën e urrejtjes. Rekomandimi nr.15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për luftimin e gjuhës së urrejtjes, përkufizon këtë të fundit si avokimi, promovimi ose nxitja në çdo formë e denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes bazuar në ngjyrën dhe racën (e perceptuar), prejardhjen kombëtare apo etnike, moshën, aftësinë e kufizuar, gjuhën, fenë apo besimin, seksin, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual apo çdo karakteristike apo statusi tjetër personal¹.

Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor të përshtatshëm për të trajtuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe për ndalimin e diskriminimit. Si anëtare e Këshillit të Evropës dhe shtet kandidat në Bashkimin Evropian, Shqipëria është pjesë e akteve ndërkombëtare përkatëse. Shqipëria ka përmirësuar shpesh legjislacionin me synim harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian. Legjislacioni aktual vlerësohet se është në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi gjuhën e urrejtjes². Kuadri ligjor aktual nuk përmban një përkufizimin për Gjuhën e Urrejtjes (Online). Megjithatë, ka disa akte ligjore të cilat përmbajnë baza ligjor për të trajtuar këtë çështje.

Pavarësisht hapave ligjorë të posaçëm të ndërmarrë në kuadrin e përafrimit, çështja e gjuhës së urrejtjes nuk është në krye të agjendës politike. Ndërsa pritet që përfaqësuesit e njerëzve, të cilët kryejnë funksionet legjislative, të jenë të partë në sjelljen e ndryshimit në mendësi dhe në përqafimin e parimeve më të larta të të drejtave të njeriut, ka raste të përdorimit të gjuhës së urrejtjes në Parlament. Anëtarët e Parlamentit dhe madje Zëvendëskryetari i Parlamentit kanë përdorur gjuhën e urrejtjes kundër komunitetit Rom. Në këtë rast, i cili ka ndodhur vitin e kaluar, Komisioneri ka lëshuar një deklaratë për shtyp duke i kërkuar Anëtarit të Parlamentit të përfshirë të bënte një sqarim, duke konsideruar faktin se përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga persona me vizibilitet të lart në media, ka ndikim më të madh në nxitjen e stereotipeve dhe sjelljeve negative.

Padyshim që partnerët e zhvillimit dhe projektet e ndryshme kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndihmën e institucioneve shtetërore në trajtimin dhe adresimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe për më tepër në ndryshimin e të kuptuarit dhe të qasurit ndaj sjelljeve dhe rasteve të gjuhës së urrejtjes. Sidoqoftë, institucionet e pavarura dhe organet gjyqësore, të ngarkuar me adresimin e segmenteve të ndryshme të sjelljeve të gjuhës së urrejtjes duhet të përmbushin përgjegjësitë e tyre

¹ Rekomandimi nr.15 i Politikës së Përgjithshme të KIE/ECRI CR(2000)21 mbi Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, i disponueshëm në adresën <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/home> (30.04.2020), fq.3

² Komisioni Evropian, Komunikimi mbi Politikën e Zgjerimit të BE Raporti i Shqipërisë, 2019 i disponueshëm në adresën: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf> (30.04.2020), fq.28

në një mënyrë më kuptimplote, të qëndrueshme dhe strategjike, duke marrë autorësi për aktivitetet që kryejnë dhe për proceset që ndërmarrin.

Për këto arsye, qëllimi i këtij raporti është kryerja e analizës së kapaciteteve të organeve të barazisë në Shqipëri për t'iu përgjigjur gjuhës së urrejtjes dhe hartimi i rekomandimeve për mënyrën si ata të mund të forcojnë kapacitetet sipas mandatit të tyre përkatësisht.

2 Kuadri ligjor mbi luftimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes

2.1 Dispozitat kushtetuese dhe ligjore lidhur me gjuhën e urrejtjes (online)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë³ (AC) përcakton barazinë përpara ligjit dhe ndalimin e diskriminimit për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore (Neni 18 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë). Kufizime të të drejtave dhe lirive mund të vendosen vetëm për një interes publik (Neni 17 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë) dhe këto kufizime nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Liria e shprehjes gëzon mbrojtje nga kushtetua dhe është subjekte e kufizimeve mbi baza ligjore proporcionale (Neni 22 dhe 23 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë). Zbatimi i dispozitave kushtetuese plotësohet nga zbatimi i drejtpërdrejtë i Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga akte të tjera ndërkombëtare për këtë lëndë sikundër Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Kushtetuta e Shqipërisë parashikon mbizotërimin (Neni 116 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë) dhe efekte të drejtpërdrejta të instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara të vetëzbatueshme (Neni 122 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë).

Shpifja (përgojimi) qëndron të jetë vepër penale (kundërvajtje) sipas Kodit Penal (KP)⁴, pavarësisht se nuk është caktuar dënim me heqje lirie por është subjekte e gjobave (Neni 120 KP). Ndërsa shpifja në nivel civil mbulohet nga Kodi Civil (Neni 625 KC)⁵.

Në 2008, Kodi Penal⁶ është ndryshuar duke vendosur disa vepra penale të cilat kryhen përmes sistemeve kompjuterike. Lista përfshin: mohimi apo apologjia pro genocidid apo krimeve kundër njerëzimit (Neni 74/a KP); përhapja e deklaratave raciste apo ksenofobike (Neni 119/a KP) dhe fyerja publike ndaj një personi “për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë” (Neni 119/b KP). Më sot, nuk ka diskutime rreth ndryshimeve të mëtejshme ndaj Kodit Penal.

Për më tepër, ndryshimet e Kodit Penal në 2013⁷, përfshijnë nxitjen e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, (Neni 265 KP), thirrjen për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to (Neni 266 KP). Motivi i orientimit seksual është listuar mes arsyeve të tjera si gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, bindjet politike, fetare apo filozofike, statusi shëndetësor, predispozita gjenetike apo aftësia e kufizuar si një rrethanë rënduese për ndëshkimin e veprave penale të përfshira në Nenin 50/j të KP.

³ Shqipëri/Ligji nr.8417/1998 *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*

⁴ Shqipëri/Ligji nr. 7895/1995 *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*

⁵ Shqipëri/Ligji nr. 7850/1995 *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*

⁶ Shqipëri/Ligji nr. 7895/1995 *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ndryshuar me Ligjin nr. 10 023/2008*

⁷ Shqipëri/Ligji nr. 7895/1995 *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ndryshuar me Ligjin nr.144/2013*

Parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit është mbrojtur nga Ligji mbi Mbrojtjen nga Diskriminimi (Ligji i Antidiskriminimit)⁸. Ligji nuk përfshin gjuhën e urrejtjes si formë diskriminimi. Megjithatë, për shkak të një interpretimi të gjerë të Nenit 3/5, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) ka cilësuar gjuhën e urrejtjes sipas kuptimit të shqetësimit⁹ (shihni pjesën 2.2 të raportit). Shqetësimi është përkufizuar si ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë (Neni 3 paragrafi 5).

Në Shkurt të këtij viti, KMD përmes një grup parlamentar ka propozuar disa ndryshime ligjore në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹⁰. Ndryshimet pasqyrojnë rekomandimet e ofruara nga organizata të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare, në përputhje me praktikën më të mirë. Një nga risitë e ndryshimeve është përfshirja e gjuhës së urrejtjes si një formë diskriminimi. Për këto arsye, gjuha e urrejtjes është përkufizuar si në vijim: Gjuha e urrejtjes është çdo formë shprehje, promovimi ose nxitje e denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes - që bazohet në një listë joshteruese të karakteristikave personale sipas nenit 1 të këtij ligji¹¹. Neni 1 i ligjit është ndryshuar duke shtuar shkaqe të tjera diskriminimi, si kombësia dhe karakteristikat personale¹². Ky përkufizim është në përputhje me Rekomandimin nr. 15 ECRI mbi luftimin e gjuhës së urrejtjes.

KMD është institucioni kryesor i ngarkuar me trajtimin e ankesave lidhur me gjuhën e urrejtjes, edhe në mungesë të një përkufizimi ligjor të gjuhës së urrejtjes. Lidhur me përkufizimin e kompetencave të KMD përkundrejt atyre të Gjykatave Penale, KMD trajton rastet administrative ndërsa Gjykatat Penale trajtojnë çështjet penale. KMD mbulon rastet të cilat fillojnë me “pa cenim ndaj veprave penale...” dhe Gjykatat penale mbulojnë ato çështje të gjuhës së urrejtjes të cilat konsiderohen si vepra penale sipas Kodit Penal.

Ligji për Mediat Audiovizive¹³ garanton se aktiviteti i transmetimit i shoqërive të jetë në përputhje me të drejtën për informacion, e bindjeve politike dhe fetare, personalitetin, dhe dinjitetin si dhe me të tjera të drejta dhe liri themelore të njeriut. Transmetimi mediatik duhet të udhëhiqet nga parimet e “moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve” dhe “respektimi i fqinjësisë së mirë midis popujve” (Neni 4). Dispozita të ngjashme përsëriten në vazhdimësi në ligj, në zbatim të kushteve të licencimit, transmetuesve kombëtar dhe tregtarë, komunitetit të transmetuesve dhe Radio Televizionit Publik Shqiptar. Ligji parashikon se shërbimi i mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të përmbajë asnjë nxitje ndaj urrejtjes mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare (Neni 32). Operatorët e shërbimeve audiovizive nuk lejohen të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi (Neni 76).

Vitin e kaluar qeveria propozoi disa ndryshime në Ligjin për Mediat Audiovizive dhe Ligjin për Komunikimet Elektronike¹⁴. Ndryshimet kanë pasur për qëllim rregullimin e mediave. Ndërhyrja justifikohet nga nevoja urgjente e adresimit të problemeve të krijuara nga media (media online) në

⁸ Shqipëri/Ligji nr.10221/2010 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁹ Intervistë me R. Gajdja Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (11.05.2020)

¹⁰ <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200227103137prligji%20PER%20MBROJT%20JEN%20NGA%20DISKRIMINI MI.pdf> (30.04.2020)

¹¹ Shqipëri/neni 3/10 i Projekt-Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

¹² Projekt-Ligj, kopje e marrë nga KMD 7.05.2020

¹³ Shqipëri/Ligji nr. 97/2013 Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë

¹⁴ Shqipëri/Ligji nr. 9918/2018 Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë

lidhje me gjuhën e urrejtjes, shkeljen e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të privatësisë¹⁵, si dhe detyrimin për të adresuar rekomandimin 15/8 të ECRI¹⁶. Janë ngritur shqetësime nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe shoqata profesionale në lidhje me pajtueshmërinë e kësaj nisme me standardet ndërkombëtare¹⁷. Draft-ndryshimet u vlerësuan si të papajtueshme me lirinë e shprehjes pasi ato i japin qeverisë shqiptare pushtet diskrecional për rregullimin e mediave në internet, duke u vendosur atyre regjistrime të detyrueshme dhe gjoba të rënda. Paketa e ndryshimeve është duke u shqyrtuar nga Komisioni i Venecias¹⁸.

2.2 Jurisprudenca

Në mungesë të një përkufizimi ligjor të gjuhës së urrejtjes (në internet), praktika gjyqësore është zhvilluar bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, në veçanti rastet e krimeve të urrejtjes, rastet e shpifjes / përgojimit në krahasim me lirinë e shprehjes dhe praktikës gjyqësore mbi antidiskriminimin. Mosmarrëveshjet me profil më të lart të shpifjeve në vitet e fundit kanë përfshirë anëtarët e parlamentit dhe politikanë të vjetër që padisin njëri-tjetrin për akuzat e korrupsionit. Shumë nga këto raste janë sjellë drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë, sepse kjo e fundit kishte juridiksion fillestar për çështjet që përfshijnë ndjekjen penale të anëtarëve të parlamentit dhe zyrtarëve të lartë. Vendimet gjyqësore shpesh ishin rezultat i një arsytimi që përpiqet të arrijë ekuilibrin midis lirisë së shprehjes dhe kufizimit proporcional të një lirie të tillë¹⁹. Në vendimin e fundit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (duke përfshirë përsëri dy politikanë) gjykata vendosi që deklaratat publike, pa 'qëllime informimi', mund të përbëjnë abuzim të lirisë së shprehjes (përkatesisht neni 22 i Kushtetutës shqiptare dhe neni 10 i KEDNJ) për sa kohë që ato mbesin mendime dhe nuk shndërrohen në fakte të vërtetuara nga ai që i shpreh ato publikisht²⁰. Liria e shprehjes mund të jetë subjekt i kufizimeve ose penalteteve të parashikuara me ligj në rastet kur (ndër të tjera) ndikon në moralin, nderin, dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve²¹. Jurisprudenca e KEDNJ citohet shpesh në vendimet gjyqësore, megjithëse në një mënyrë sipërfaqësore dhe nganjëherë jo në mënyrë jo koherente²².

Kategoria e dyte e çështjeve është ajo kundër terrorizmit dhe aktiviteteve terroriste të gjykuara nga ish Gjykata e Krimeve të Rënda²³ të cilat përfshijnë dhe krimet e urrejtjes (neni 265 e Kodit Penal)²⁴. Promovimi i gjuhës së urrejtjes për shkaqe fetare dhe racore është identifikuar si pjesë e aktiviteteve terroriste. Mediat sociale apo hapësirat fetare janë përdorur për të promovuar deklaratat e urrejtjes me qëllim për të rekrutuar apo për të bindur persona të tjerë për t'i shërbyer aktiviteteve të organizatave terroriste²⁵. Në një nga këto çështje një qytetar shqiptar i konvertuar në Mysliman ekstremist gjatë studimeve të tij jashtë shtetit, pasi u kthye në Shqipëri organizoi një grup personash në jug të Shqipërisë. Grupi u radikalizua dhe përdori WebPages për të promovuar këndvështrime ekstreme dhe për të predikuar luftën e Shenjtë në Siri. Ata nxitën urrejtjen dhe dhunën kundër

¹⁵ Shqipëri, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, procesverbal i takimit datë 25.11.2019 i disponueshëm në adresën: www.parliament.al (30.04.2020)

¹⁶ Rekomandimi nr.15 i Politikës së Përgjithshme të KiE/ECRI CR(2000)21 mbi Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, i disponueshëm në adresën <https://www.coe.int/en/ëeb/european-commission-against-racism-and-intolerance/home> (30.04.2020)

¹⁷ Paketa e Zgjerimit të BE (2019) *Liria e shprehjes dhe shoqëria e informacionit dhe media 2019*, e disponueshme në adresën: ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement (30.04.2020)

¹⁸ <https://www.venice.coe.int/ëebforms/events/?id=2895> (30.04.2020)

¹⁹ Shqipëri/Gjykata e Lartë, Vendimi nr.7 (7.06.2010), www.gjykatalarte.al

²⁰ Shqipëri / Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi nr. 208 (21.01.2019) www.gjykatatiranes.gov.al

²¹ Shqipëri /Gjykata e Lartë, Vendimi nr.8 (5.06.2015)

²² Irion, K.; Cavaliere, P.; Pavli, D (2015) *Studim Krahasimor i Praktikave më të Mira Evropiane mbi rregullimin e përmbajtjes online, veçanërisht të shpifjes online në këndvështrim të propozimeve ligjore të Shqipërisë, KiE, i disponueshëm në adresën: <https://hdl.handle.net/11245/1.493315>* (30.04.2020), fq. 65

²³ Shqipëri / Gjykata e Krimeve të Rënda është quajtur Gjykata e Posaçme për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin

²⁴ Shqipëri / Gjykata e shkallës së parë për Krimet e Rënda, Vendimi nr. 58 (03.05.2016), Vendimi nr. 46, (04.05.2017), Vendimi nr. 1 (24.01.2018)

²⁵ S. Simoni, M. Xhaxho (2019) *Raport mbi Parandalimin e Ekstremizmit Të Dhunshëm dhe Radikalizmit në Bashkinë Roskovec dhe Zonat Rurale në Këtë Bashki*, Qendra Gruaja, Komuniteti dhe Mjedisi i disponueshëm në adresën www.qag-al.org (30.04.2020)

besimeve të tjera duke mbështetur organizatën terroriste ISIS dhe predikuan idetë radikale dhe terroriste të organizatës si dhe ishin përdorues të lëndëve narkotike. Grupi u akuzua ndër të tjera për shkelje të nenit 265 të Kodit Penal.

Kategoria e tretë përfshin çështjet e gjykuara nga gjykatat e zakonshme (civile dhe administrative) që përfshijnë raste antidiskriminimi. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është treguar pro përkufizimit të gjuhës së urrejtjes, si pjesë e interpretimit më të gjerë të disa dispozitave të ligjit kundër diskriminimit, veçanërisht nenit 1 (shkaqet e diskriminimit), nenit 3/5 (shqetësimi) dhe nenit 7 (mbrojtje nga diskriminimi i ligjit). Jurisprudenca për gjuhën e urrejtjes e cilësuar si formë diskriminimi është shumë e kufizuar. KMD raporton vetëm një rast të gjykuar nga gjykata administrative në dy vitet e fundit (shihni pikën 5.1 të raportit)²⁶.

2.3 Mekanizmat e vetërregullimit dhe kodet e sjelljes

Në përgjigje të rekomandimeve të ECRI ²⁷ për forcimin e masave jopenale kundër gjuhës së urrejtjes mes masave të vetërregullimit, Kuvendi, dhe mediat kanë miratuar Kodet e tyre të Sjelljes.

Kodi i Sjelljes së Deputetit²⁸ bashkëngjitur Rregullave Procedurale të Kuvendit ndalon deputetët që të përdorin gjuhë nxitëse të urrejtjes dhe diskriminimit për shkaqe të fesë, gjinisë, bindjeve politike apo orientimeve seksuale. Kjo është thelluar më shumë në Udhëzuesin e Detajuar për Sjelljen në Kuvend²⁹ i cili kërkon që deputetët e Kuvendit të shmangin çdo sjellje diskriminuese të fshehur apo të tërthortë për shkaqe racore, të orientimit seksual, të bindjeve dhe të çdo çështje tjetër (neni 2)³⁰. Deputetët do të jenë subjekte të masave disiplinore të rënda (neni 65/1)³¹ në rast të përdorimit të gjuhës diskriminuese dhe fyese për shkaqe të tilla si raca, gjinia, bindjet politike dhe orientimet seksuale.

Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive³² përfshin dhe përcakton parimet, rregullat, kushtet dhe praktikat për transmetimin audioviziv në Republikën e Shqipërisë. Kodi i Transmetimit është hartuar si instrument zbatues i ligjit Për Mediat Audiovizive në përputhje me Direktivën e BE-së 2010/13 (“Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive”) dhe aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si KEDNJ. Kodi përshkruan disa parime për shërbimet audiovizive midis të cilave janë dekurajimi i urrejtjes, intolerancës dhe diskriminimit për shkaqe të tilla si raca, gjinia, orientimi seksual, besimit politik (1.5); respektimi i së drejtës për barazi; dhe mosdiskriminim nga transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve (1.12).

2.4 Praktika e mirë

Miratimi i Kodit të Sjelljes dhe Udhëzimit të Detajuar mbi Kodin e Sjelljes të Deputetit të Kuvendit përbën një zhvillim të mirë për luftimin e gjuhës së urrejtjes të përdorur nga politikanët. Studime dhe vëzhgime të ndryshme tregojnë se figurat publike dhe deputetët shpesh përdorin gjuhë fyese ndaj

²⁶ Shqipëri/ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Vendimi nr. 4319 (18.12.2019)

²⁷ ECRI (2015) *Raport mbi Ciklin Monitorues të Pesëmbëdhjetë* fq. 19-20 i disponueshëm në adresën: <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/albania> (30.04.2020)

²⁸ Shqipëri /Vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 61/2018 *mbi miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit në Republikën e Shqipërisë* i disponueshëm në adresën: www.parlament.al (30.04.2020)

²⁹ Shqipëri / Vendim i Byrosë së Kuvendit të Shqipërisë nr.19 (27.09.2018) *Për Miratimin e Udhëzuesit të Detajuar për Sjelljen në Kuvend* i disponueshëm në adresën: www.parlament.al (30.04.2020)

³⁰ Shqipëri / Vendim i Byrosë së Kuvendit të Shqipërisë nr.19 (27.09.2018) *Për Miratimin e Udhëzuesit të Detajuar për Sjelljen në Kuvend* i disponueshëm në adresën: www.parlament.al (30.04.2020)

³¹ Shqipëri /Kuvendi i Shqipërisë *Rregullat Procedurale të Kuvendit*, të disponueshme në: www.parlament.al (30.04.2020)

³² Shqipëri /AMA Vendimi nr.228 (11.12.2017) *Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive* i disponueshëm:

<http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/AUDIOVISUAL-MEDIA-BROADCASTING-CODE-.pdf> (30.04.2020)

njëri-tjetrit dhe shprehen me konotacion të keq për grupet e marxhinalizuara. Kodi dhe Udhëzimi janë duke u zbatuar dhe disa masa disiplinore janë marrë tashmë kundër deputetëve³³.

3 Kuadri Institucional për Luftimin dhe Parandalimin e Gjuhës së Urrejtjes përtej Organeve të Barazisë

3.1 Rolet dhe Kompetencat e Institucioneve dhe Organizatave të tjera (përtej Organeve të Barazisë)

Gjuha e barazisë është një çështje që përfshin institucione publike dhe private. Në dy vitet e fundit aktorë të ndryshëm janë përfshirë në procesin e përmirësimit të legjislacionit për adresimin më të mirë të çështjeve të gjuhës së urrejtjes dhe për përmirësimin e qasjes në drejtësi të viktimave të diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Ministria është e përfshirë në aktivitete antidiskriminuese³⁴ dhe ka hartuar disa strategji për promovimin e barazisë dhe antidiskriminimit. Ministria e Arsimit gjithashtu ka një rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave të të drejtave të njeriut tek të rinjtë. Ministria e Arsimit ishte pjesë e fushatës kombëtare "Jo gjuhës së urrejtjes"³⁵ dhe ishte angazhuar në aktivitete me organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat rinore³⁶. Ministria e Brendshme, përmes Akademisë së Sigurisë është angazhuar në aktivitete të përbashkëta trajnimi për strukturat policore së bashku me Shkollën e Magjistraturës.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) gjithashtu është përfshirë në aktivitete "Jo Gjuhës së Urrejtjes". Përveç monitorimit të zbatimit të detyrimeve ligjore për operatorët e shërbimeve audiovizive³⁷, AMA ka botuar një studim mbi Gjuhën e Urrejtjes në Media Audiovizive³⁸.

3.2 Roli i gjykatave

Gjykatat shqiptare të të gjitha juridiksioneve dhe të gjitha niveleve përfshirë Gjykatën Kushtetuese³⁹ kanë një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes. Krimet e urrejtjes në kuptimin e nenit 265 të kodit penal aktualisht gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm⁴⁰. Çështjet e antidiskriminimit gjykohen nga të dy gjykatat e specializuara administrative dhe gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, seksionet civile dhe penale. Gjykatat shqiptare mbledhin statistika bazuar në metodologjinë dhe periodicitetin e aprovuar nga Ministria e

³³ <https://www.parlament.al/VendimeByroseKuvendits>

³⁴ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka marrë pjesë në aktivitetet kushtuar Javës kundër Diskriminimit 13-20 Shkurt 2020 të disponueshme në : https://www.coe.int/sq/ëeb/tirana/neës/-/asset_publisher/SENeHJ2ESZrË/content/ëeek-against-discrimination-3-12-february-2019?_101_INSTANCE_SENeHJ2ESZrË_vieëMode=vieë/ (30.04.2020)

³⁵ Shqipëria është pjesë e Këshillit të Evropës në Lëvizjen Kundër Gjuhës së Urrejtjes që nga viti 2014, e disponueshme në: <https://www.coe.int/en/ëeb/no-hate-campaign/national-campaigns1> (30.04.2020)

³⁶ <https://arsimi.gov.al/bashke-jo-gjuhes-se-urrejtjes/>

³⁷ në 2019, AMA ka njoftuar RTSH për transmetime të cilat përmbanin gjuhë urrejtjeje mbi baza etnike

³⁸ AMA /Komiteti i Pajtuëshmërisë (2018) *Gjuha e Urrejtjes në Median Audiovizive* gjendet ne <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/HATE-SPEECH-1.pdf> (30.04.2020)

³⁹ Neni 134 Kushtetuta e Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese vendoset në lëvizje nga individët, Avokati i Popullit, OJQ-të dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁴⁰ Shqipëri/Kodi i Procedurës Penale Ligji nr.7905, 31.05.1995 ndryshuar me Ligjin nr. 35/2017 (30.03.2017)

Drejtësisë⁴¹ dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor⁴² ose bazuar në kërkesat e organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Statistikat mblidhen dhe raportohen bazuar në dispozitat e kodeve materiale, (objekt ankesash) p.sh. neni 608 i kodit civil *detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i demit* ose llojit të veprës penale. Prandaj, është shumë e vështirë të sigurohen statistika për rastet e diskriminimit direkt nga statistikat e gjykatës, përveç nëse u bëhet kërkesë e drejtpërdrejtë. Statistikat gjyqësore për çështjet penale të përfshira edhe ato për nenet 119 / a, 119 / b, 265, 266 dhe 50 j të Kodit Penal, mund të merren nga raporti vjetor Statistikor i prodhuar nga MD⁴³, ose nga raportet tremujore të hartuara nga gjykatë dhe dorëzuar në MD.

3.3 Roli i policisë dhe avokatëve të shtetit

Shqipëria është zotuar të ndër marrë veprime për të adresuar mungesën e raportimit dhe zhvillimin e aftësive të agjencive ligjzbatuese, prokurorisë dhe gjyqtarëve në parandalimin, hetimin dhe procedimin e krimit të urrejtjes. Raporti i paraqitur nga Shqipëria në ODIHR për vitin 2018 tregon se strukturat e policisë po punojnë për t'i kushtuar vëmendjen e duhur çështjes. Gjatë vitit 2018, në bazë të nenit 265 të Kodit Penal, u evidentuan 6 vepra penale, nga të cilat 3 u proceduan penalisht dhe 13 autorë janë gjetur të përfshirë⁴⁴. Policia e shtetit mbledh statistikat për vepra të ndryshme penale dhe ato raportohen në buletin mujor, të cilat raportojnë punën e policisë së shtetit⁴⁵. Raporti mbledh statistikat për rastet që përfshijnë krime kundër personave, pronave, drogës dhe trafikimeve të tjera, korrupsionit dhe krimeve kompjuterike.

Sidoqoftë, nën raportimi i krimit të urrejtjes dhe diskriminimit, veçanërisht kundër personave LGBTI, mbetet një çështje e rëndësishme në të gjithë Evropën Jug-Lindore, si dhe në Shqipëri. Tre të katërtat e njerëzve LGBTI, raportojnë se kanë pësuar abuzim psikologjik në Shqipëri (76%) dhe 65% persona LGBTI janë të ekspozuar ndaj diskriminimit⁴⁶. Rastet e krimit të urrejtjes dhe diskriminimit që raportohen, shpesh nuk regjistrohen, hetohen dhe ndiqen siç duhet. Ekziston një bashkëpunim i kufizuar midis institucioneve të drejtësisë dhe ka nevojë për një vëmendje të zgjeruar për viktimat në të gjithë zinxhirin e drejtësisë. Si rezultat, regjistrohet një numër i kufizuar dënimesh për krime të urrejtjes ndaj personave LGBTI.

Qasja më e përshtatshme duket të jetë e përqendruar në forcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin e zinxhirit të drejtësisë. Gjatë vitit 2019, Komiteti Holandez i Helsinkit, Policia Kombëtare Holandeze dhe Policia e Shtetit Shqiptar organizuan së bashku një kurs trajnimi në Tiranë për të bashkëpunuar në përgjigjen ndaj krimit të urrejtjes dhe diskriminimit LGBTI për partnerët e zinxhirit të drejtësisë nga Tirana, Vlora, Lezha dhe Kukësi. Ky aktivitet ka mbledhur 15 përfaqësues të policisë, 9 prokurorë, 9 zyrtarë për barazi gjinore të njësive administrative, 8 përfaqësues të OJQ-ve dhe 1 përfaqësues nga zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Materiali i trajnimit u bazua në manualin e Këshillit të Evropës për "Policimin e Krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI": Trajnimi për një përgjigje

⁴¹ Shqipëri, Udhëzimi i MD nr.4 15.04.2009 *Për plotësimin e të dhënave statistikore*, i disponueshëm në www.ministriaedrejtises.gov.al (30.04.2020)

⁴² KLGJ Vendimi nr. 25 datë 7/2/2019 *mbi Informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore*, i disponueshëm në www.klgj.al (30.04.2020)

⁴³ Shqipëri Ministria e Drejtësisë Vjetari Statistikor 2018, botuar në 2019, <http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/Vjetari-Statistikor-2018-PDF.pdf> (30.04.2020)

⁴⁴ Raporti mbi Krimet e urrejtjes, OSCE ODIHR, Shqipëri, Viti 2018, i disponueshëm në: <https://hatecrime.osce.org/albania?year=2018> (14.04.2020)

⁴⁵ Statistikat e krimit të urrejtjes grumbullohen nga departamenti i antiterrorizmit në zyrën e përgjithshme të policisë së shtetit. Statistikat mblidhen bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Shtetëror të Policisë së Shtetit nr. 677 09.07.2018 Për përcaktimin e veprave penale subjekt i punës së policisë së shtetit.

⁴⁶ NDI (2015) Sondazh mbi çështjet e LGBTI në Ballkan, i disponueshëm në: https://www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll (30.04.2020);

profesionale të policisë u lehtësua nga dy trajnues të certifikuar, të ardhur nga Policia Kombëtare Holandeze. Për më tepër, policia e cila është hallka e parë e marrjes së informacionit për krimin e urrejtjes ka krijuar një manual për të trajtuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes⁴⁷.

Avokati i Shtetit nuk ka një rol të qartë në çështjet e gjuhës së urrejtjes; megjithatë ka një rol të rëndësishëm për ekzekutimin dhe zbatimin e gjyqimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përveç se përfaqësuesi shtetëror në gjykimet e GJEDNJ kundër Shqipërisë, sipas ndryshimeve të fundit në Ligjin e Avokatit të Shtetit⁴⁸, ka marr kompetenca për bashkërendimin e mekanizmit për garantimin e zbatimit të duhur të tyre (nenet 19/1-10). Avokati i Shtetit ka botuar vendimet e GJEDNJ kundër Shqipërisë dhe i ka vendosur ato në dispozicion në gjuhën shqipe në faqen zyrtare të internetit⁴⁹.

3.4 Mekanizmat e vetërregullimit të lidhur me median

Një zhvillim i fundit pozitiv në lidhje me vetë-rregullimin e mediave në internet është miratimi i Kodit të Etikës së Gazetarit⁵⁰ dhe Udhëzimeve Etike për Gazetarinë Online⁵¹. Kodi i Etikës së Gazetarit⁵² është hartuar nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë (përfshirë gazetarët) në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore për Lirinë e Shprehjes dhe Mediave në Evropën Juglindore” (JUFREX).

Kodi i Etikës është një instrument vetë-rregullues i cili synon të drejtojë, forcojë dhe përmirësojë cilësinë e gazetarisë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së gazetarëve në Shqipëri. Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë dhe respektojnë frymën e Kushtetutës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pika 8 (Gjuha e Urrejtjes) e Kodit të Etikës përcakton se Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës. Çdo botim duhet të mos specifikojë origjinën, etnicitetin, kombësinë, racën, fenë apo orientimin seksual të një grupi apo individ, përveç rasteve kur gjykohet e rëndësishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë faktet dhe opinionet e paraqitura në publikim.

Pika 9 e Udhëzimeve Etike për Gazetarinë Online (Udhëzimet) përmban një përkufizim të gjuhës së urrejtjes online sipas të cilës nënvizohet se “Gjuha e urrejtjes kuptohet si shprehje që kanë për qëllim të nxisin urrejtje të thellë, dhunë reale apo diskriminim ndaj individëve apo grupeve të caktuara, sidomos pakicave të çdo lloji”. Udhëzimet kanë parashikuar një sistem politikash për mbikëqyrjen dhe parandalimin e publikimit dhe komenteve që promovojnë gjuhën e urrejtjes. Mekanizmat e menaxhimit të përmbajtjes dhe mekanizmat e rishikimit të ankesave publike duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve. Sa i përket gjuhës së urrejtjes, redaktorët dhe operatorët e faqes në internet duhet të përdorin mekanizma efektivë për të identifikuar dhe çaktivizuar përmbajtje të tilla sa më shpejtë që të jetë e mundur. Udhëzimet e mësipërme janë gjithashtu të vlefshme deri në masën kur mund të jenë të zbatueshme, për faqet e rrjeteve sociale të mediave, duke marrë parasysh posaçërisht ndikimin e mundshëm të postimeve. Stafi përgjegjës për moderimin e komenteve duhet të trajnohet në mënyrën e duhur bazuar në legjislacionin përkatës kombëtar dhe standardeve

⁴⁷ Trajnimi ishte pjesë e projektit të Luftimit ndaj Diskriminimit dhe Mbrojtjes së të Drejtave LGBT në Shqipëri, i disponueshëm në: <https://www.nhc.nl/themes/building-up-rule-of-laë/promoting-rights-trafficked-persons/countering-discrimination-and-protecting-lgbti-rights-in-albania/> (30.04.2020)

⁴⁸ Shqipëri/ Ligji nr.10018/2008 *Për Avokatin e Shtetit*, ndryshuar me ligjin nr.86/2018 i disponueshëm në: <http://www.avokaturashtetit.gov.al/ëp-content/uploads/2013/12/Ligji-Nr.-10018-dat%C3%AB-13.11.2008-%E2%80%9CP%C3%ABr-Avokatur%C3%ABn-e-Shtetit%E2%80%9D-i-ndryshuar.pdf> (30.04.2020)

⁴⁹ <http://www.avokaturashtetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjyqates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg> (30.04.2020)

⁵⁰ Shqipëri/*Kodi i Etikës së Gazetarit* (2018) i disponueshëm në <https://kshm.al/en/about-us/code-of-ethics/> (30.4.2020)

⁵¹ Shqipëri/*Udhëzime etike për gazetarinë online* (2018) të disponueshme në: <https://kshm.al/ëp-content/uploads/2018/04/ETHICAL-GUIDELINES-FOR-ONLINE-JOURNALISM-7.pdf> (30.04.2020)

⁵² Shqipëri/*Kodi i Etikës së Gazetarit* (2018) i disponueshëm në: <https://kshm.al/ëp-content/uploads/2018/04/Kodi-i-Etikës-final-English-4.pdf> (30.04.2020)

ndërkombëtare për mbrojtjen e grupeve të cenueshme. Gjithashtu, Udhëzimet përcaktojnë që redaktorët ose operatorët e faqes së internetit duhet të monitorojnë faqet e tyre të internetit (dhe faqet e tyre përkatëse të rrjeteve sociale) dhe të marrin masa për të parandaluar ose ndaluar publikimin e përmbajtjes të paligjshme, ose që cenon dinjitetin ose privatësinë e njeriut, ose përbën një gjuhë të urrejtjes (pikat 8-17).

3.5 Faktorët promovues dhe pengues për qasje në drejtësi dhe ndihmë ndaj viktimave

Një nga faktorët promovues që akoma duhet të testohen për përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe ndihmën ndaj viktimave është miratimi i ligjit të ri për ndihmën juridike të 2017⁵³. Ligji ka shtuar një kategori të re që përfiton nga ndihma juridike dhe përbëhet nga grupe të cenueshme, të tilla si viktima të dhunës në familje, të abuzimit seksual, të mitur në konflikt me ligjin, njerëz që kanë qenë subjekt i diskriminimit të drejtpërdrejtë ose tërthortë të parashikuar me vendim të organeve kompetente, në këtë rast me një vendim të KMD (art.11). Ata mund të përfitojnë pavarësisht nga statusi i tyre ekonomik. Ministria e Drejtësisë ka miratuar aktet e dhura ligjore në vitin 2019. Ligji është hartuar në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, megjithatë zbatimi i duhur i tij do të varet shumë nga trajtimi i gjyqtarëve dhe ndërgjegjësimi i palëve⁵⁴. Ndryshimet në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, të paraqitura në fillim të vitit 2020, do të nxisin zbatimin dhe përmirësimin e mbrojtjes së viktimave të diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes. Përveç prezantimit të një përkufizimi të gjuhës së urrejtjes, ndryshimet do të heqin autorizimin për OJQ-të që përfaqësojnë viktimat e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes dhe do t'i lejojnë OJQ-të të përfaqësojnë interesat kolektive të viktimave direkt në KMD⁵⁵.

3.6 Praktika e mirë

Këshilli Shqiptar i Medias⁵⁶ ka krijuar një bazë të dhënash online me shkeljet e kodit të etikës. Ky është procesi i parë për të rritur ndërgjegjësimin e vetë-rregullimit. Baza e të dhënave do të përmbajë gjetjet nga një proces monitorimi që po vazhdon brenda AMC që prej një vit. Qëllimi është të rritet ndërgjegjësimi i publikut për numrin e madh të shkeljeve të kodit të etikës nga Media shqiptare dhe për faktin se vetë-rregullimi funksionon vetëm nëse publiku është i përfshirë në mënyrë aktive në këtë proces. Publiku mund të ketë qasje në bazën e të dhënave përmes një sistemi kërkimi që siguron kategori sipas neneve të Kodit të Etikës dhe Gjuha e Urrejtjes është një prej tyre. Bordi i Ankesave shërben si një alternative ndaj gjykatës⁵⁷. Meqenëse kjo është një iniciativë e organizatave jofitimprurëse, zbatimi i saj i suksesshëm do të varet nga financimi dhe mbështetja që u jepet organizatave.

4 Roli i organeve të barazisë në luftimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes në praktikë

⁵³ Shqipëri / Ligji nr. 111/2017 *Për Ndihmën Ligjore* i disponueshëm në: www.drejtesia.gov.al (30.04.2020)

⁵⁴E. Toska (2018) Komiteti Shqiptar i Helsinkit *Raport studimor Për aksesin në drejtësi të grupeve vulnerabël*, i disponueshëm në http://www.ahc.org.al/ep-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf

⁵⁵ Neni 33 i Projekt Ligjit për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.10221/2010 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi i disponueshëm në:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200227103137priligji%20PER%20MBROJT%20JEN%20ONGA%20DISKRIMINIMI.pdf> (30.04.2020)

⁵⁶ Këshilli Shqiptar i Medias është një organizatë jo fitimprurëse qëllimi i së cilës është përfundimi dhe garantimi i respektimit të Kodit të Etikës si formë ndërvepruese e vetë-rregullimit përmes një mekanizmi të zgjidhjes së ankesave. [https://kshm.al/en/about-us/history/\(30.4.2020\)](https://kshm.al/en/about-us/history/(30.4.2020))

⁵⁷ Ankesat mund të dorëzohen në adresën: [https://kshm.al/en/complaints/file-a-complaint/\(30.04.2020\)](https://kshm.al/en/complaints/file-a-complaint/(30.04.2020))

4.1 Roli dhe kompetencat e organit/organeve të barazisë

Organet e barazisë janë ato të krijuara për të mbrojtur dhe siguruar mbështetje të pavarur viktimave të diskriminimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Sipas kuadrit ligjor shqiptar⁵⁸, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është identifikuar në mënyrë të qartë si organi kryesor për promovimin e barazisë dhe luftën kundër diskriminimit në Shqipëri. KMD mund të cilësohet si një organ promovues dhe gjykues i barazisë.

Ligji për antidiskriminimin në Shqipëri ka përafuar në një farë mase *Acquis*-in e BE-së⁵⁹ për trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim, i cili në vetvete nuk adreson gjuhën e urrejtjes. Prandaj, roli i organeve të barazisë në luftimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes do të shihet në kontekstin e promovimit të trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) siguron mbrojtje efektive të çdo forme të diskriminimit (neni 21). KMD shqyrton ankesat e individëve ose të një grupi individësh që pretendojnë / deklarojnë se janë diskriminuar; kryen hetime administrative; dhe zbaton sanksione administrative (neni 32). Sa i përket mbrojtjes së viktimave, Komisioneri përfaqëson ankesat pranë organeve gjyqësore dhe paraqet mendime me shkrim për çdo çështje që lidhet me diskriminimin, me kërkesë të gjykatës që shqyrton atë çështje.

Pjesë e kompetencave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë të llojit promovues dhe u referohen detyrave të rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve edukative mbi të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe nxitjes së parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara (neni 32).

Për më tepër, Komisioneri është i ngarkuar të monitorojë zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, të botojë raporte dhe të hartojë rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin; të kryejë anketime mbi situatën e diskriminimit; si dhe të lëshojë rekomandime për autoritetet kompetente veçanërisht për propozimin e ndryshimeve në legjislacion ose futjen e legjislacionit të ri. Komisioneri kontribuon në raportimin mbi zbatimin e konventave përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe, sipas rastit, paraqet raporte ndaj organeve rajonale dhe ndërkombëtare.

Për të lehtësuar zbatimin e duhur të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, ligji kërkon që Komisioneri të zhvillojë një dialog të rregullt me grupet e interesit, përfshirë organizatat joqeveritare dhe detyron të gjitha subjektet publike dhe private të mbështesin punën e Komisionerit, në mënyrë të veçantë përmes sigurimit të informacionit të kërkuar.

4.2 Roli dhe mandati i institucioneve të tjera të pavarura (si institucionet e Avokatit të Popullit)

Avokati i Popullit në Shqipëri është një organ kushtetues mandati dhe kompetencat e të cilit bazohen mbi Kushtetutën e 1998 (nenet 60-63) dhe Ligjin shqiptar të Avokatit të Popullit të 1999⁶⁰. Mandati i avokatit të popullit realizohet përmes kompetencave për të raportuar mbi statusin e mbrojtjes së të

⁵⁸ Shqipëri/ Ligji nr. 10 221, 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i disponueshëm në <https://kmd.al/ep-content/uploads/2018/05/1308053956-Ligji-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi.pdf> (09.04.2020)

⁵⁹ Sikundër deklarohet në shënimet fundore të Ligjit nr. 10 221/2010 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji është përafuar me Direktivën e Këshillit 2000/43/EC (29.06.2000), Direktivën e Këshillit 2000/78/EC (27 .10. 2000), Direktivën e Këshillit 2004/113/EC (13.12.2004), Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit 2006/54/CE (5.07.2006)

⁶⁰ Shqipëri/ Ligji nr. 8454/1999 *Avokati i Popullit* ndryshuar me ligjin nr. 8600 /2000 dhe Ligjin 9398/2005 dhe Ligjin 115/2014

drejtave dhe lirive, për të ofruar rekomandime për institucionet publike që shkelin të drejtat dhe liritë e tilla dhe për të pasur akses të plotë në informacionin e administratës publike. Ky institucion heton çështjet individuale të bazuara në ankesa ose me iniciative të tij.

Avokati i Popullit në Shqipëri është organ i barazisë të llojit promovues, i cili lëshon rekomandime jo detyruese për entitetet administrative të cilat kanë shkelur të drejtat dhe njëherazi i rekomandon viktimave t'i referohen gjykatës. Ligji përkatës parashikon detyrimin e organit administrativ që t'i përgjigjet rekomandimeve të nxjerra nga Avokati i Popullit, brenda 30 ditëve nga marrja e rekomandimit, duke dhënë shpjegime të arsyeshme për rastin në fjalë dhe veprimet ose masat e marra në atë drejtim. Në rast se Avokati i Popullit nuk është i kënaqur me reagimin e organit administrativ, ai ka të drejtë ta çojë çështjen në organin më të lartë administrativ në hierarki. Nëse nuk ka reflektim në lidhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet Kuvendit përmes një raporti me masat e propozuara për t'i dhënë fund shkeljes së të drejtave përkatëse⁶¹.

4.3 Zbatimi i kompetencave (ligjore) nga organet e barazisë

Siç parashihet në seksione të ndryshme të këtij raporti, Avokati i Popullit dhe KMD kanë intensifikuar veprimet e tyre në veçanti në dy vitet e fundit në lidhje me çështjet e gjuhës së urrejtjes. Vëmendje e veçantë i është kushtuar gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj grupeve të cënueshme, personave me aftësi të kufizuara, komunitetit LGBTI, grave, romëve dhe komunitetit egjiptian. KMD ka trajtuar disa raste që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe të dy institucionet janë angazhuar në disa aktivitete ndërgjegjësuese, të tilla si konferenca, seminare dhe botim materialesh. Prandaj, trajtimi i çështjeve të gjuhës së urrejtjes mbetet një fushë e KMD-së, ndërsa aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimin janë të përbashkëta nga të dy institucionet.

Zbatimi i vendimeve të KMD mbetet çështje shqetësuese. KMD ka vështirësi në lidhje me njoftimin e vendimit që lëshon dhe ekzekutimin e gjobave. Në shumë raste, veçanërisht kur janë të përfshirë gazetarët, adresat e marrësve shpesh nuk gjenden. Në ndryshimet në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, të paraqitura në vitin 2020, KMD ka propozuar që njoftimi i vendimit të tij të bëhet me njoftim publik. Media kombëtare do të jetë e detyruar të njoftojë publikisht vendimet e KMD-së që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes. Në lidhje me ekzekutimin e gjobave, KMD ka propozuar që një vendim kundër diskriminimit që rezulton me gjobë të marrë formën e titullit ekzekutiv, pasi të jetë tejkualuar afati prej 30 ditësh për ekzekutimin e tij⁶².

Organet e barazisë nuk kanë ende persona të specializuar që punojnë për çështjet e gjuhës së urrejtjes. Sidoqoftë, nën KMD, drejtoria për hetimin administrativ është drejtoria më e përfshirë në çështjet e gjuhës së urrejtjes. Ndërsa, nën Avokatin e Popullit kjo çështje mbulohet nga komisioneri për çështje të përgjithshme. Futja e gjuhës së urrejtjes si një formë diskriminimi, e aprovuar më parë nga Parlamenti, do të kërkojë një staf më të specializuar. Sidoqoftë, si anëtar i EQUINET (Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë), gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është përfshirë në 7 grupe pune të EQUINET të cilat do të shërbejnë për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira megjithëse jo të gjitha grupet e punës kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes⁶³.

⁶¹ Shqipëri/ Ligji nr. 8454/1999 Avokati i Popullit ndryshuar me ligjin nr. 8600 /2000 dhe Ligjin 9398/2005 dhe Ligjin 115/2014, Kreu III Ankesat Rregullat e shqyrtimit të çështjeve dhe kompetencat e Avokatit të Popullit

⁶² Draft propozimet ligji për mbrojtjen nga diskriminimi neni 33/1

⁶³ Raport i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Janar-Qershor 2019, Faqja 36, e disponueshme në <https://www.kmd.al/ep-content/uploads/2020/02/Raport-KMD-Janar-Qershor-2019-perfundimtar.pdf> (07.04.2020);

4.4 Strategjitë zyrtare dhe jozyrtare të organeve të barazisë

KMD ka miratuar planin e tij strategjik për 2018-2021 me mbështetjen e një projekti KiE/BE⁶⁴. Strategjia tregon ambicien e KMD për të vendosur veten si aktor kryesor në fushën e promovimit të barazisë duke rritur në mënyrë të mëtejshme kuptimin e përbashkët të situatës së mosdiskriminimit midis të gjithë palëve të interesuara publike dhe jopublike, dhe duke ndërmarre drejtpërsëdrejti veprime ligjore kundër diskriminimit. Qëllimet strategjike të KMD përfshijnë veprime në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe institucioneve në Shqipëri në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi dhe rolin e dukshëm të KMD, duke rritur në maksimum ndikimin e vendimeve të jurisprudencës, duke kontribuar në politik-bërje mbi baza provash përmes monitorimit dhe kërkimit të situatave të zbatimit të legjislacionit të anti-diskriminimit, duke nxitur efikasitetin dhe efencën e organizimit të brendshëm dhe duke forcuar dhe zgjeruar përhapjen e punës së tij dhe rrjetin e mbështetjes së bashkëpunëtorëve.

Avokati i Popullit ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për 2018-2022⁶⁵. Një nga qëllimet strategjike është përmirësimi i kushteve dhe trajtimi i grupeve vulnerabël, personave LGBTI, rome, pakicave dhe grave, dhe mbrojtja e tyre nga çdo formë shkeljeje. Për të përmbushur këtë qëllim strategjik, Avokati i Popullit është angazhuar të përgatisë raporte hije; të monitorojë situatën e grupeve minoritare, përfshirë romët dhe / ose egjiptianët që jetojnë në Shqipëri rregullisht; të zgjerojë partneritetet dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me shoqërinë civile për aktivitete që synojnë përmirësimin e kushteve për gratë dhe vajzat në Shqipëri, përfshirë trajtimin e stereotipeve gjinore dhe praktikave të dëmshme ndaj grave; të përfshihet në mënyrë aktive në nisma dhe procese kundër ksenofobisë, dhe të monitorojë treguesit e aktiviteteve ksenofobike në Shqipëri (Plani i Veprimit).

4.5 Praktika e mirë

Në vitin 2019, në kuadrin e fushatës elektorale evropiane, KMD u angazhua në aktivitetin e promovimit të 10 Rekomandimeve EQUINET për antidiskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes gjatë fushatave elektorale⁶⁶. KMD ka përkthyer rekomandimet dhe i ka vënë ato në dispozicion në faqen e internetit dhe mediat sociale të shoqëruara me video promovuese. U janë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, partive politike, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bashkive, Avokatit të Popullit, Autoritetit Audioviziv dhe organeve të tjera të përfshira.⁶⁷

5 Jurisprudenca mbi gjuhën e urrejtjes

5.1 Rastet e gjuhës së urrejtjes (online) të trajtuara nga organet e barazisë

Në dy vitet e fundit (2018-2019) KMD ka trajtuar disa raste që lidhen me gjuhën e urrejtjes. Në vitin 2018, KMD ka shqyrtuar 5 ankesa dhe ka gjetur diskriminim në 3 prej tyre. Ndërsa në vitin 2019 ka shqyrtuar 12 ankesa dhe 2 raste “ex-officio” që përfshijnë gjuhën e urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI. Nga 12 ankesa, diskriminimi u konstatua në 3 raste. Që nga 20 prilli, KMD nuk ka marrë asnjë ankesë, as nuk ka iniciuar raste “ex-officio”⁶⁸.

Rastet kanë përfshirë gjuhën e urrejtjes të përdorur në media, por edhe në Kuvend. Rastet e iniciuara nga Shoqata e Lëvizjes Rinore Rome dhe Egjiptiane, kanë përfshirë gjuhën fyese ose referenca të këqija

⁶⁴ KMD (2017) Plani Strategjik 2018-2021 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i mbështetur nga projekti i KiE/BE Rritja e Efektivitetit të Sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Anti-diskriminimit (30.04.2020)

⁶⁵ I disponueshëm në <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/index/home> (30.04.2020)

⁶⁶ https://equineteurope.org/ép-content/uploads/2019/05/equinet_election_recommendation_final.pdf

⁶⁷ Shihni raportin e gjysmë vitit të KMD fq 38-39 i disponueshëm në: www.kmd.al (30.04.2020)

⁶⁸ Informacion i marrë nga KMD gjatë intervistimit të tij (24.04.2020)

të konotacionit për komunitetin egjiptian. KMD ka gjetur diskriminim bazuar në nenin 7 (Mbrojtje nga diskriminimi) dhe nenin 3/5 (Shqetësimi) të ligjit të antidiskriminimit, si dhe në trajtimin e barabartë bazuar në nenin 14 të KEDNJ-së. Arsyeimi i KMD përfshiu gjithashtu interpretimin e nenit 10 të KEDNJ-së dhe 22 të Kushtetutës shqiptare së bashku me kufizimin e lirisë bazuar në nevojën e mbrojtjes së dinjitetit individual dhe ndikimit të keq që një deklaratë e tillë mund të ketë tek individët jo të mirëinformuar, në përputhje me vendimin e GJEDNJ Féret kundër Belgjikës⁶⁹.

Në dy rastet e ndërmarra “ex-officio”⁷⁰ KMD ka trajtuar gjuhën e përdorur në dy programe televizive kundër komunitetit LGBT. KMD gjeti diskriminim në bazë të neneve 1, 7 dhe 3/5 të Ligjit kundër diskriminimit dhe bazuar në kufizimin e lirisë së fjalës siç parashikohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Rasti i dytë ka përfshirë një deklaratë publike të një figure publike e cila shprehej vazhdimisht kundër komunitetit LGBTI. Përsëri diskriminimi u gjet në bazë të neneve 7 dhe 3/5 të ligjit, ndërsa kufizimi i lirisë së fjalës u bazua në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Dy raste të tjera u iniciuan nga Fondacioni Down Syndrome⁷¹ për gjuhën që përdoret nga figurat publike në Facebook të cilët përdorin gjuhë denigruese të asociuar me persona me aftësi të kufizuara si Sindroma Daun dhe Autizmi. Diskriminimi u gjet bazuar në nenin 7 dhe 3/1 të ligjit të antidiskriminimit shoqëruar me nevojën e kufizimit proporcional të lirisë së fjalës të diktuar nga fakti se ekziston nevoja për të parandaluar të gjitha format e shprehjes që promovojnë, përhapin dhe justifikojnë urrejtjen bazuar në intolerancën (Erbakan kundër Turqisë)⁷².

Në tre raste kur u konstatua diskriminim, KMD ka vendosur që personi që shkakton diskriminimin (duke përdorur gjuhën e urrejtjes) të kërkojë falje publike. Në një rast ka lëshuar një gjohë ndaj personit që ka shkaktuar diskriminim. Gjoha është subjekte ekzekutimit⁷³.

5.2 Organet e barazisë dhe gjykatat

Ndërveprimi midis KMD dhe gjykatave karakterizohet nga një numër i shtuar i çështjeve kur KMD është e pranishme në procesin gjyqësor⁷⁴. Siç parashikohet nga ligji, të gjitha vendimet e KMD mund të ankimohen në gjykatë (gjykatat civile ose administrative në varësi të ankesave të palëve), KMD ka të drejtë të përfaqësojë individë që janë subjekt i diskriminimit⁷⁵, gjykata ka detyrimin të njoftojë KMD-në çdo herë që ka një rast diskriminimi⁷⁶, ka të drejtë të kërkojë nga KMD në çdo fazë të procesit të hetojë dhe të paraqesë gjetjet e hetimit⁷⁷. Ndryshimet e fundit të Kushtetutës së Shqipërisë⁷⁸ (neni 134 (e) ka përcaktuar KMD si një nga palët që ka të drejtë rekursi në Gjykatën Kushtetuese për çështje në kompetencë të tij. Gjatë periudhës së raportimit (2018-2020) vetëm një vendim i KMD-së⁷⁹ në lidhje me gjuhën e urrejtjes u apelua nga i pandehuri në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Rasti përfshinte një deklaratë të bërë nga një Drejtor dhe Prodhues i mirënjohur i Konkurseve të Bukurisë, i cili gjatë një emisioni në televizion ka përdorur gjuhë diskriminuese kundër komunitetit LGBT. Gjykata ka mbështetur vendimin e KMD-së dhe ka theksuar se ka pasur diskriminim për shkak të gjuhës së

⁶⁹ ECtHR/15615/07 (10.12.2009) Feret kundër Belgjikës

⁷⁰ Shqipëri/KMD Vendimi nr. 108 (21/08/2019)

⁷¹ KMD Vendimi nr.246 datë 05/12/2018 dhe KMD Vendim nr. 120, datë 9/09/2019

⁷² ECtHR/59405/00 (6.07.2006) Erbakan kundër Turqisë

⁷³ Informacion i marrë nga Departamenti i hetimit administrative i KMD (24 .04.2020)

⁷⁴ Numri i rasteve është rritur nga 3 në 2012 në 66 në 2018 Raporti Vjetor 2018 i KMD fq.45

⁷⁵ Shqipëri /Neni 34/3 i Ligjit nr.10221/2010 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁷⁶ Shqipëri /Neni 36/3 i Ligjit nr.10221/2010 Për mbrojtjen nga Diskriminimi

⁷⁷ Shqipëri/Neni 36 / 4 dhe neni 34/1 i Ligjit nr.10221/2010 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁷⁸ Shqipëri, Ligji nr.8577/2000 Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese ndryshuar me Ligjin nr.99/2016

⁷⁹ KMD Vendimi nr.108/2019 (30.04.2020)

përdorur ndaj paditësit⁸⁰. KMD raporton që gjykatat gradualisht po marrin rolin e tyre për mbrojtjen e diskriminimit. Gjykatat janë më shumë të përfshirë në thelbin e çështjeve⁸¹.

5.3 Raste të ndërmarra “ex-officio” nga organet e barazisë

Veprimi “ex-officio” i KMD-së bazohet në nenin 32/1/c të Ligjit për Anti-diskriminimin. Kjo dispozitë përdoret gjerësisht nga KMD. Sikundër është shprehur raporti i 2018⁸², KMD ka trajtuar 16 raste “ex-officio” megjithatë asnjë nga këto raste nuk ka pasur lidhje me gjuhën e urrejtjes.⁸³ Në 2019, KMD ka trajtuar dy raste lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe në të dyja rastet është përdorur gjatë programeve televizive kundër komunitetit LGBTI. Në rastin e parë⁸⁴ KMD ka gjetur se gjuha e përdorur gjatë emisionit televiziv ka vendosur komunitetin LGBTI në pozitë diskriminuese në formën e shqetësimit sikundër përcaktohet në nenin 3/5 të ligjit për Anti-Diskriminimin. Në përfundim të hetimit, KMD konkludoi duke i kërkuar personit të interesuar të kërkonte falje publike brenda 15 ditësh. Në situatën e dytë të ngjashme, nuk u paraqit nevoja për kryerjen e veprimeve të mëtejshme, pasi KMD zbuloi se personi në fjalë kishte kërkuar tashmë falje publike menjëherë pas deklaratave të tij diskriminuese⁸⁵.

5.4 Gjuha e urrejtjes (online) dhe baza e të dhënave e çështjeve të organeve të barazisë

Faqja e internetit e KMD mbulon gjithë aktivitetet e institucionit dhe është e përditësuar në mënyrë të shpeshtë. Gjithë rastet e trajtuara nga KMD botohen në faqen e internetit të KMD-së⁸⁶. Rastet nuk ndahen në kategori; megjithatë, në raportin vjetor, KMD bën një ndarje të rasteve bazuar në shkaqet e diskriminimit dhe mbi fushën e shërbimeve sikundër të përcaktuara në mbrojtjen nga diskriminimi. Rastet e gjuhës së urrejtjes janë cituar në raport si një kategori rastesh të trajtuara nga KMD, vetëm në formën e statistikave⁸⁷.

5.5 Nevojat e organeve të barazisë për të trajtuar (më shumë) raste/përmirësimin e trajtimit të çështjeve

Siç u përmend më parë në këtë raport, ekziston një përfshirje më e madhe e KMD-së në trajtimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes. KMD ka përdorur gjithashtu kompetencat “ex-officio” për të adresuar gjuhën e urrejtjes të përdorur në emisione televizive dhe mediat online. Sidoqoftë, puna e KMD do të lehtësohej nga një përkufizim i qartë ligjor i gjuhës së urrejtjes, i shoqëruar me trajnime mbi situatat e gjuhës së urrejtjes përkundrejt atyre të lirisë së shprehjes⁸⁸.

5.6 Praktika e mirë

Asnjë praktikë e veçantë nuk shënohet për raportim.

⁸⁰ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vendimi nr.4319/2019 (30.04.2020)

⁸¹ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vendimi nr.4319/2019 (30.04.2020)

⁸² KMD ka iniciuar 8 raste në 2017 dhe 8 në 2018 dhe të 16 rastet janë trajtuar gjatë 2018.

⁸³ KMD (2018) Raporti Vjetor, i disponueshëm në : www.kmd.al (30.04.2020), fq.33

⁸⁴ KMD Urdhri nr.101 datë 03.06.2019 “Për ndjekjen ‘ex officio’ të çështjes së shprehjeve të përdorura nga shtetasi P. B. në emisionin “Thumb” të datës 25.05.2019” (30.04.2020)

⁸⁵ KMD Urdhri nr. 193 datë 17.10.2019 “Për ndjekjen ‘ex officio’ të çështjes së shprehjeve të përdorura nga shtetasi K.Gj. kundër komunitetit LGBT në programin televiziv 360 Grade” (30.04.2020)

⁸⁶ Vendimet e KMD deri në 2013 janë botuar në <https://www.kmd.al/vendime-te-komisionerit-2020/> (30.04.2020)

⁸⁷ KMD (2018) Raporti Vjetor, i disponueshëm në : www.kmd.al (30.04.2020)

⁸⁸ Komente të marra gjatë intervistës online me përfaqësuesit e KMD (24.04.2020)

6 Identifikim i bashkëpunimit mbi rastet ndërmjet organeve të barazisë dhe palëve të interesuara

6.1 Kontakti i parë për viktimat e gjuhës së urrejtjes (online)

Organizatave e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm sepse në shumicën e rasteve ato janë pikat e para të kontaktit për viktimat e çdo forme të diskriminimit ose të shkeljeve të të drejtave të njeriut, përfshirë për përdorimin kundër tyre të gjuhës së urrejtjes (në internet). Në Shqipëri ka disa organizata që kanë qenë aktive jo vetëm në promovimin e të drejtave të njeriut, por në mbështetjen e ankesave ndaj individëve që demonstrojnë sjellje diskriminuese ose përdorim të gjuhës së urrejtjes. Shembuj mund të jepen nga organizata të tilla si Lëvizja Rinore Egjiptiane & Rome, Center for Community Actions, Ambasada Pink, dhe Fondacioni Down Syndrome. Ambasada Pink ka krijuar një forum në internet për të marrë ankesa të cilat adresohen më tej ndaj KMD, Avokatit e Popullit, gjykatave ose prokurorisë⁸⁹. Sidoqoftë, individët mbeten më aktivë dhe numri i ankesave të paraqitura nga ata direkt është më i lartë në krahasim me numrin e ankesave të paraqitura nga OSHC-të⁹⁰.

6.2 Transmetimi i rasteve nga organet e barazisë ndaj institucioneve të tjera

Organet e barazisë bashkëpunojnë me institucione të tjera për të trajtuar çështjet e paraqitura pranë tyre. KMD bashkëpunon me institucione të tjera si Parlamenti, gjykatat, zyrat e prokurorisë për të shmangur procedura paralele. Informacioni përftohet përmes kërkesave me shkrim të cilat u drejtohen institucioneve të lartpërmendura.

KMD raporton se në një rast që ka përfshirë përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga një deputet i Kuvendit, KMD ka tërhequr ankesat pasi ka marrë informacion me shkrim se është iniciuar procedimi disiplinor i Kuvendit ndaj këtij personi. KMD komunikon dhe referon çështjet në prokurori. KMD është shprehur jo shume i kënaqur me nivelin e reagimit nga prokuroria. Sipas mendimit të KMD-së, i mungon trajnimi dhe ekspertiza e duhur për të pasur sukses në trajtimin e çështjeve të gjuhës së urrejtjes ose çështjeve të krimit të urrejtjes⁹¹.

6.3 Bashkëpunimi mes organeve të barazisë dhe Avokatit të Popullit

Bashkëpunimi i realizuar së fundmi ndërmjet KMD dhe Avokatit të Popullit në Shqipëri ka sjellë krijimin e Aleancës Pa Urrejtje. KMD dhe Avokati i Popullit janë pjesë e programit të Këshillit të Evropës, Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Projekti i KiE mbështet Konferencën Kombëtare “Liri Pa Urrejtje” e organizuar nga Avokati i Popullit. Në këtë konferencë është nënshkruar “Memorandumi i Bashkëpunimit mbi luftën Kundër Gjuhës së Urrejtjes” dhe është themeluar “Aleanca Pa Urrejtje” e cila përfaqëson një qasje të përbashkët në promovimin e diversitetit dhe luftën e gjuhës së urrejtjes në Shqipëri. Ky përfaqëson një model të përsosur të bashkërendimit të veprimeve dhe përpjekjeve të përbashkëta në luftimin e gjuhës së urrejtjes (online). KMD dhe Avokati i Popullit kanë zhvilluar gjithashtu disa aktivitete të përbashkëta, kryesisht konferenca dhe seminare të kryera në disa qytete dhe universitete.

6.4 Bashkëpunimi i organeve të barazisë dhe OSHC-ve

Organizatave e shoqërisë civile janë një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës së barazisë dhe të drejtave të njeriut. Ndikimi i tyre shfaqet qartë pasi ato arrijnë të paraqesin dhe mbrojnë interesat e grupeve të ndryshme. Sikundër parashikuar në planin strategjik të KMD-së, pothuajse në të gjitha qëllimet

⁸⁹ Intervistë në internet me përfaqësuesin e Lëvizjes Rinore Rome dhe Egjiptiane (23.04.2020)

⁹⁰ Raporti vjetor i KMD-së 2018, numri i ankesave nga individët është 232 ndërsa numri i ankesave nga OJQ-të me interes të ligjshëm është 26, të disponueshëm në: www.kmd.al (30.04.2020), fq.31

⁹¹ Intervistë me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, R. Gajdja (11.05.2020).

strategjike, KMD konsideron OShC-të si një nga partnerët kryesorë zbatues. Lidhur me këtë, bashkëpunimi midis OShC-ve dhe KMD-së po përparon në drejtim të vizioneve strategjike siç janë aktivitetet e ndërgjegjësimit, ose përhapja e ndikimit, por ende bashkëpunimi mbetet i kufizuar lidhur me ndikimi i vendimeve mbi rastet dhe provat e zbatimit.

Organizatave e shoqërisë civile janë palë të cilat kanë të drejtë të referojnë raste në KMD (neni 32)⁹². Megjithatë ekzistojnë vështirësi nga ana e OShC-ve në referimin e rasteve për shkak se kërkohet të plotësohet kushti i interesit të ligjshëm, përsëri KMD raporton një numër të shtuar të rasteve të depozituara nga OShC-të ndaj KMD-së (nga 7 ankesa të regjistruara në 2015 në 23 ankesa të regjistruara në 2018)⁹³. Për më tepër, çështjet e gjuhës së urrejtjes të depozituara ndaj KMD nga ana e OShC-ve vijnë me interes të ligjshëm. Organizatat e shoqërisë civile janë të kënaqura me rezultatin e vendimeve të lëshuara nga KMD, megjithatë, dëshirojnë të shohin një ndikim pozitiv më të gjerë përmes përhapjes së duhur dhe zbatimit të këtyre vendimeve⁹⁴. Këto çështje trajtohen në ndryshimet e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Organizatave e shoqërisë civile angazhohen në aktivitete të ndryshme me Avokatin e Popullit. Ata marrin pjesë në tryeza të rrumbullakëta, seminare, ditë të hapura dhe konsiderohen si përfituesit kryesorë të këtyre aktiviteteve. Grupet e shënjestruara për Avokatin e Popullit përfshijnë komunitetet dhe grupe sociale të drejtat e të cilëve nuk mbrohen në mënyrën e duhur nga autoritetet, të tilla si gratë, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, romët, anëtarët e komunitetit LGBTI, personat me sëmundje mendore në burgje dhe pakicat. Organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel komuniteti mbështesin Avokatin e Popullit për t'iu drejtuar këtyre komuniteteve duke vepruar mbi parimin sipas të cilit të drejtat e njeriut nuk janë privilegj, por një detyrim i shtetit për të krijuar kushtet e nevojshme që qytetarët të ushtrojnë të drejtat dhe liritë e tyre⁹⁵.

6.5 Nevojat e organeve të barazisë për të krijuar/përmirësuar bashkëpunimin me palët e interesuara përkatëse

Organet e barazisë punojnë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike, OShC-të dhe botën akademike. Ka shumë shembuj që tregojnë se bashkëpunimi midis këtyre institucioneve është intensifikuar. Aleanca Pa Urrejtje e krijuar midis organeve të ndryshme përfaqëson një përpjekje shumë të mirë për të luftuar gjuhën e urrejtjes. Sidoqoftë siç u theksua me të drejtë nga KMD, ka nevojë për të përmirësuar bashkëpunimin e zyrave rajonale ndërmjet KMD-së dhe Avokatit të Popullit. Roli i tyre duhet të forcohet në veçanti për adresimin e fenomeneve të gjuhës së urrejtjes në nivelin lokal.

6.6 Praktika e mirë

Në Dhjetor 2019, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli Shqiptar i Medias (OJQ) nënshkruan një memorandum bashkëpunimi, duke themeluar "Aleancën kundër Urrejtjes". Aleanca do të rrisë ndërgjegjësimin dhe promovimin e dialogut veçanërisht midis të rinjve dhe ndërmjet OJQ-ve dhe institucioneve publike në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe ndikimit të saj në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror shqiptar; do të zhvillojë studime dhe do të ofrojë rekomandime; do të inkurajojë kryerjen e publikimeve të statistikave të krimeve të urrejtjes sipas kodit penal në mënyrë të vazhdueshme. Nisma konsiderohet si hap i jashtëzakonshëm pasi këto institucione nuk varen vetëm nga mbështetja e organizatave ndërkombëtare. Institucionet shtetërore të përfshira në këtë iniciativë duhet të angazhohen me burime njerëzore dhe financiare.

⁹² Shqipëri Ligji nr.10221/2010 Për mbrojtjen nga diskriminimi

⁹³ KMD (2018) Raporti vjetor, i disponueshëm në : www.kmd.al (30.04.2020), fq.32

⁹⁴ Intervistë me Komisionerin për Mbrojtje nga Diskriminimi, R. Gajdja (11.05.2020).

⁹⁵ Informacioni i përfituar nga intervistë online me V. Shurdha, Avokati i Popullit, (22.04.2020)

7 Roli i organeve të barazisë në ndërgjegjësimin dhe promovimin e informacionit rreth gjuhës së urrejtjes

7.1 Aktivitetet e organeve të barazisë për rritjen e ndërgjegjësimin rreth gjuhës së urrejtjes (online)

Ndërgjegjësimi është identifikuar si një nga shtyllat e punës së organeve të barazisë. Në të përfshihen botime, trajnime, konferenca, ditë të hapura, aktivitete në media dhe leksione të hapura. KMD dhe Avokati i Popullit kanë intensifikuar aktivitetet e tyre të ndërgjegjësimin në lidhje me gjuhën e urrejtjes.

Këtë vit, në datat 3-12 shkurt 2020, me rastin e 10 vjetorit të miratimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe me iniciativë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u organizua "Java kundër Diskriminimit". Ky event u përbë nga një seri aktivitete të kryera në Tiranë dhe në qytete të tjera si Vlora, Elbasani dhe Korça në kuadër të promovimit të parimeve të barazisë, mosdiskriminimit dhe qeverisjes së mirë, duke përfshirë të gjithë palët e interesuara, partnerët dhe aktorët e lidhur me fushën e luftimit të gjuhës së urrejtjes, diskriminimit si dhe fuqizimit të romëve. Eventu përfundoi me mbajtje në ambientet e Kuvendit ku u ftuan deputetë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile, organizata të drejtave të njeriut për të folur për përpjekjet dhe përparimin në dekadën e fundit në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të barabarta për qytetarët e Shqipërisë. Eventu mbështet nga Bashkimi Evropian dhe nga programi i Këshillit të Evropës "ROMACTED - Promovimi i Qeverisjes së Mirë dhe Fuqizimit të Komunitetit Rom në Nivel Vendor" dhe nga programi i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" – Projekti "Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri" ⁹⁶.

7.2 Nevojat e organeve të barazisë për të rritur nivelin e ndërgjegjësimin ndaj gjuhës së urrejtjes (online)

Efikasiteti i aktiviteteve që synojnë rritjen e ndërgjegjësimin rreth gjuhës së urrejtjes varet nga gjerësia e veprimeve të kryera nga institucionet e barazisë dhe aktorët e përfshirë. Organet e barazisë dhe OSHC-të duhet të kenë një rol më proaktiv në adresimin e gjuhës së urrejtjes. Grupet vulnerabël duhen fuqizuar dhe mobilizuar për të qenë pjesë e aktiviteteve të tyre, të përfshihen në fushata avokuese dhe aktivitete të shpërndarjes së informacioneve. Nga ana tjetër ka lindur nevoja për të promovuar mesazhe pozitive përmes shembujve pozitivë dhe inkurajues nga këto komunitete. Mediave dhe organet e barazisë duhet të angazhohen në promovimin e këtyre shembujve.

Çështja e gjuhës së urrejtjes duhet të prezantohet gjithashtu në nivelin lokal. Për këtë, autoritetet lokale dhe OSHC-të lokale duhet të bashkëpunojnë me zyrtarë rajonale të organeve të barazisë.

Fushatat edukative janë gjithashtu të nevojshme. KMD duhet ketë mbështetje në iniciativën / idenë e tij për përfshirjen e gjuhës së urrejtjes dhe çështjeve antidiskriminuese në kurrikulat arsimore të viteve të para.

Duhet inkurajuar dhe mbështetur organizimi i trajnimeve dhe seminareve të vazhdueshme për gjykatësit, avokatët, prokurorët dhe përfaqësuesit e organeve të barazisë për diskutimin dhe analizimin e çështjeve të gjuhës së urrejtjes / krimeve të urrejtjes.

⁹⁶ <https://www.coe.int/en/ëeb/tirana/-/romacted-programme-at-the-ëeek-against-discrimination-in-albania> (20.04.2020)

7.3 Raporti vjetor i organeve të barazisë dhe gjuha e urrejtjes (online)

Përgatitja dhe prezantimi i raporteve vjetore pranë Komisioneve të Kuvendit dhe seancave plenare është një detyrim ligjor i cili zbatohet nga të dy organet e barazisë. KMD⁹⁷ dhe Avokati i Popullit përgatisin raportet vjetore për punën e kryer në vitin e kaluar, të cilat më pas vendosen në dispozicion në faqen e internetit të institucioneve. Për sa kohë që gjuha e urrejtjes nuk është e përcaktuar si një nga format e diskriminimit, ajo nuk mund të ketë një kapitull të veçantë në raportin e KMD. Megjithatë, gjuha e urrejtjes është e cilësuar në raportin e KMD-së, dhe përfshihen informacionet e duhura rreth kuadrin ligjor, detyrave dhe aktiviteteve të brendshme ose të jashtme kushtuar gjuhës së urrejtjes.

7.4 Aktivitete promovuese dhe të marrëdhënies me publikun të organeve të barazisë lidhur me gjuhën e urrejtjes (online)

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit kanë qenë gjithmonë e më aktivë në rritjen e ndërgjegjësimit në vitet e kaluara përmes trajnimeve, publikimeve, ditëve të hapura dhe aktiviteteve mediatike. Shumica e fushatave të tyre janë përqendruar në tema specifike (p.sh. dhuna gjinore) ose në grupe të shënjestruara specifike (p.sh. romët). Një nga nevojat e identifikuara të komunikimit në këtë fazë është realizimi i një fushatë më të përgjithshme për ndërgjegjësimin rreth asaj çfarë do të thotë diskriminim dhe mbi mekanizmat ekzistues të ankesave dhe institucionet.

7.5 Nevojat e organeve të barazisë për zhvillimin (e mëtejshëm) të një Strategjie Komunikimi mbi Gjuhën e Urrejtjes (online)

KMD ka zhvilluar strategjinë e komunikimit në 2018 dhe kjo strategji shërben si bazë për çdo veprim komunikimi të kryer nga KMD⁹⁸. Plani i komunikimit i KMD synon rritjen e pranisë së KMD-së në media, rritjen e pranisë dhe shpërndarjes së informacioneve rreth punës së KMD-së, më konkretisht vendimeve dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit, si dhe rritjen e ndërveprimit midis KMD-së dhe të institucioneve të tjera të lidhura si Avokati i Popullit, OJQ-të, Kuvendi, Gjykatat etj. Nga ana tjetër, Avokati i Popullit nuk ka pasur një strategji të veçantë për komunikimin e punës së këtij institucioni në të kaluarën, por aktivitetet e komunikimit publik kanë qenë pjesë e misionit thelbësor të Avokatit të Popullit dhe janë përfshirë në "Planin Strategjik 2018-2022".

Zhvillimi i një strategjie komunikimi mbi Gjuhën e Urrejtjes Online ecën paralelisht me përfshirjen dhe rolin që kanë të dy institucionet në luftën kundër gjuhës së urrejtjes online. Siç parashihet përmes raportit, gjuha e urrejtjes është kthyer në një shqetësim dhe shpeshherë trajtohet nga të dy institucionet.

7.6 Praktika e mirë

Avokati i Popullit i ka dedikuar konferencën vjetore për këtë vit 2020 gjuhës së urrejtjes. Konferenca me titull "Liri pa Urrejtje: Liria e Shprehjes Përballë të Drejtave të tjera të Njeriut" ka mbledhur zyrtarë të lart të shtetit si Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, përfaqësues të organeve të barazisë, aktivistë dhe profesionistë dhe donatorë ndërkombëtarë. Gjatë konferencës, panelistët analizuan qasje të thelluara ndaj nocionit të luftimit të gjuhës së urrejtjes nga një perspektivë antidiskriminuese. Në këtë kontekst, pjesëmarrësit prekën çështje të rëndësishme që lidhen me lirinë e shprehjes, si dhe mekanizmat rregullues dhe vetë-rregullues të mediave, ndërsa iu referuan juridiksionit të Gjykatës së Strasburgut për këtë çështje. Në këtë aktivitet u lançua "Aleanca Pa Urrejtje" e cila do të zhvillojë një agjendë të bashkuar që do të zbatohet nga anëtarët në tre vitet e ardhshme (deri në 2023).

⁹⁷ KMD (2018) Raporti Vjetor, i disponueshëm në: www.kmd.al (30.04.2020),

⁹⁸ KMD (2018) *Strategjia e Komunikimit*, kopje shkresore marrë nga KMD (11.05.2020)

8 Kërkime dhe sondazhe mbi gjuhën e urrejtjes

8.1 Përfshirja e organeve të barazisë në kryerjen e studimeve dhe/ose sondazheve

Kërkimet dhe sondazhet mbi situatën e gjuhës së urrejtjes janë shumë të pakta në Shqipëri. Edhe pse çështja e përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj grupeve të ndryshme po merr më shumë vëmendje, nuk ka dokumente të posaçme në formën e studimeve ose sondazheve mbi situatën e gjuhës së urrejtjes. Kjo kryesisht lidhet me mungesën e burimeve dhe kapaciteteve të organeve të pavarura dhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në veçanti, dhe me mungesën e njohjes së ndikimit real të gjuhës së urrejtjes në jetën e viktimave dhe shoqërisë në përgjithësi. KMD raporton se aktualisht është përfshirë në disa nisma të implementuara nga OSHC që përfshijnë studime dhe sondazhe mbi çështje antidiskriminimi. Një nga aktivitetet ka të bëjë me zbatimin e vendimeve të KMD kundër autoriteteve lokale; të tjerët kanë të bëjnë me studimet e vendimeve gjyqësore. KMD po mendon gjithashtu të bëjë një studim për përdorimin e fjalëve të caktuara me konotacion negativ dhe ndikimin e tyre të mundshëm në komunitete të ndryshme.

Nga ana tjetër, organizatat e shoqërisë civile nuk kanë qenë shumë aktive në këtë drejtim, ndonjëherë për shkak të mungesës së financimit i cili varet nga partnerët e zhvillimit. Një studim ndër disa studime të kësaj fushe është ai i nisur nga Ambasada Pink në maj 2018 mbi situatën e ngacmimit në bazë të homofobisë në shkollat⁹⁹, i cili është realizuar në shkollat e mesme në 6 qytetet më të mëdha në Shqipëri. Të dhënat nga sondazhi tregojnë se shumica e mësuesve (66%) qëndrojnë të heshtur përballë ngacmimit në bazë të homofobisë. Kur u pyetën për rolin e prindërve, 70% e mësuesve që u përgjigjën thanë që ata nuk do të mbështesin një fëmijë të prindërve LGBTI. Ky studim identifikoi mungesën e gatishmërisë së mësuesve për të mbrojtur fëmijët dhe adoleshentët nga diskriminimi, bullizmi, ngacmimi, dhuna dhe abuzimi. Djemtë rezultuan më të prekur nga ngacmimi ndërsa për sa i përket përdorimit të gjuhës ekstremiste dhe të urrejtjes të dhënat janë alarmante, 1 (një) nga 5 nxënës dhe 1 (një) nga 8 mësues përdorin terma ekstremistë dhe të gjuhës së urrejtjes.

8.2 Nevojat e organeve të barazisë për të zbatuar në mënyrë më efektive dhe për të përhapur rezultatet e studimeve/sondazheve

Duke pasur parasysh faktin se nuk ka studime apo sondazhe të kryera nga organet e barazisë, nuk ka rekomandime për të adresuar në këtë drejtim. KMD duhet të forcojë bashkëpunimin me OSHC-të dhe aktorët e tjerë, në mënyrë që të kryejë anketime dhe studime të përbashkëta. Aktualisht KMD-së i mungojnë burimet financiare dhe njerëzore për të ushtruar aktivitete të tilla.

8.3 Praktika e mirë

Nuk ka praktika të veçanta për analizim.

9 Përfshirja dhe aktivitetet e bashkëpunimit mbi luftimin e gjuhës së urrejtjes

⁹⁹ Për më shumë informacione vizitoni <https://www.zeriamerikes.com/a/4417976.html> (20.04.2020)

9.1 Përfshirja e organeve të barazisë në projekte për luftimin e gjuhës së urrejtjes (online) dhe nevoja të mëtejshme

Organet e barazisë në Shqipëri janë mbështetur nga donatorë dhe projekte të ndryshme që synojnë forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe promovimin e sundimit të ligjit në Shqipëri. KMD është një nga përfituesit kryesorë të projektit KIE / BE për Promovimin e Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri¹⁰⁰. Aktiviteti i "Aleancës Pa Urrejtje" do të mbështetet përmes dy projekteve të Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Faza II", përkatësisht projekti për "Promovimin e Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri" dhe projekti për "Lirinë e shprehjes dhe median (JUFREX)"¹⁰¹.

Javën kundër diskriminimit u mbajt gjatë 3-12 shkurt 2020 nga KMD. Eventet e javës u mbështetën nga programi i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "ROMACTED 'Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimi i romëve në nivelin lokal' dhe programi i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës' Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë " - projekti mbi " Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Shqipëri "¹⁰².

Një tjetër projekt me temë "Lufta Kundër Diskriminimit dhe Mbrojtja e të Drejtave LGBTI në Shqipëri"¹⁰³ po zbatohet nga Komiteti Holandez i Helsinkit në bashkëpunim me COC Nederland dhe Policinë Kombëtare Holandeze, i cili filloi në 1 Tetor 2017 dhe do të zgjasë deri më 31 Dhjetor 2020. Ky projekt është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës, në kuadrin e MATRA. Ai gjithashtu bazohet në një qasje të kombinuar multi-sektoriale dhe përbëhet nga dy komponentë. Komponenti i parë përqendrohet në rritjen e raportimit, hetimit, regjistrimit dhe ndjekjes penale të incidenteve të krimit të urrejtjes dhe diskriminimit ndaj komunitetit LGBTI në Shqipëri duke forcuar kapacitetet e policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve për t'iu përgjigjur ngjarjeve të krimit të urrejtjes dhe diskriminimit përmes seminareve të përbashkëta , trajnimeve, vizitave studimore, zhvillimit të kurrikulës dhe fushatave. I dyti përqendrohet në promovimin e projekteve në nivel lokal për të përmirësuar pozicionin dhe situatën e individëve LGBTI përmes ndihmës të njëjësive të qeverisjes vendore në zhvillimin e planeve lokale të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për personat LGBTI.

Përveç projekteve kryesore të lartpërmendura, janë ndërmarrë edhe disa nisma të tjera për luftimin e gjuhës së urrejtjes. Shqipëria u bë pjesë në Mars 2014 e fushatës "Jo Gjuhës së Urrejtjes", e iniciuar nga Këshilli i Evropës. Që nga ajo kohë, ministria përgjegjëse për rininë ka organizuar aktivitete të ndryshme rreth qëllimit të fushatës. Më e fundit u organizua nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve¹⁰⁴ në 25 qershor 2019 dhe konsistoi në prezantimin e fushatës në një rrjet më të gjerë të organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe diskutime për zhvillimin e një plani të përbashkët për luftimin e gjuhës së urrejtjes (online) nga Ministria dhe OSHC-të. Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu kanë zbatuar nisma sporadike që kontribuojnë në edukimin e të drejtave të njeriut dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes (në internet). Përkatësisht, UNITED for Action Intercultural, Qendra Rinore Perspektiva dhe Projekte Vullnetare Ndërkombëtare organizuan në maj 2019, në Durrës, një konferencë " Power of Coexistence: Turn it on! Bridge, Cooperate, Overcome!". Në vitin 2018, Qendra Rinore "Perspektiva" organizoi në Durrës një kurs trajnimi që shënjestronte gazetarët dhe blogerët e rinj. Kursi i trajnimit, me një titull shumë

¹⁰⁰ <https://www.coe.int/en/ëeb/tirana/promotion-of-diversity-and-equality-in-albania> (20.04.2020)

¹⁰¹ <https://www.coe.int/en/ëeb/tirana/-/no-hate-alliance-a-joint-approach-against-discrimination-and-hate-speech> (17.04.2020)

¹⁰² <https://www.coe.int/en/ëeb/tirana/-/romacted-programme-at-the-ëeek-against-discrimination-in-albania>

¹⁰³ <https://www.nhc.nl/protecting-lgbti-rights-albania/> (20.04.2020)

¹⁰⁴ <https://arsimi.gov.al/bashke-jo-gjuhes-se-urrejtjes/> (20.04.2020)

goditës "Vaksina kundër gjuhës së urrejtjes në media", mblodhi 25 studentë të gazetarisë, blogerë të rinj dhe aktivistë të komunitetit nga Shqipëria, Kosova, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Serbia, Turqia dhe gjithashtu nga vendet e BE-së, të cilët ishin të interesuar për forcimin e aftësive të tyre në krijimin e tregimeve kundër stigmave dhe paragjykimeve shoqërore; dhe duke kontribuar në krijimin e narrativave pozitive të komunikimit ndërkulturor të të rinjve në nivelin kombëtar dhe rajonal.

Me bashkëpunimin e organizatave të shoqërisë civile që mbështesin komunitetin LGBTI, organizata "Stonewall", e financuar nga Ministria e Jashtme dhe e Commonwealth-it, hartoi një Manual për Qasje të Komunitetit LGBT në Drejtësi¹⁰⁵, i cili përmbledh mësimet e marra nga aktivistët që mbrojnë të drejtat e komuniteteve LGBT, nga Ballkani Perëndimor dhe Mbretëria e Bashkuar.

9.2 Bashkëpunimi Dypalësh dhe Ndërtimi i Rrjeteve Rajonale/Ndërkombëtare të Organeve të Barazisë dhe Nevojat e tyre të ardhshme

Sa i përket aktiviteteve të bashkëpunimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një anëtar aktiv i EQUINET (Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë), pasi është dhe pjesë e grupeve të punës të EQUINET të cilat synojnë zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. Për më tepër, pas Memorandumit të Mirëkuptimit të krijuar nga Institucionet e Barazisë të Evropës Jug-Lindore, takimet vjetore shërbejnë si një platformë shumë e mirë e bashkëpunimit. Në Tetor 2018, Komisioneri Shqiptar organizoi në Shqipëri konferencën e tretë rajonale me temën "Pavarësia e Organeve të Barazisë". Pjesëmarrja në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare u jep organeve të barazisë mundësinë për të forcuar bashkëpunimin e tyre dhe shkëmbimin e praktikave më të mira.

9.3 Praktika e mirë

Nuk nënvizohen praktika të veçanta.

10 Përfundime dhe rekomandime

Analiza tregon se Shqipëria po bën përparim të mirë në adresimin e gjuhës së urrejtjes, në përputhje me kuadrin ligjor ndërkombëtar, standardet dhe praktikat më të mira. Ndryshimet në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, do të përmirësojnë aspektet ligjore për luftimin e gjuhës së urrejtjes. Sapo të hyjnë në fuqi ndryshimet, institucionet e barazisë dhe drejtësisë nuk do të kenë asnjë justifikim për të mos rritur numrin e çështjeve të trajtuara. Megjithatë, fakti që KMD ka trajtuar tashmë disa raste të gjuhës së urrejtjes edhe në mungesë të një përkufizimi ligjor mund të konsiderohet si një fillim pozitiv. Nga ana tjetër, vërehet një intensifikim i aktiviteteve të ndërgjegjësimit të organeve të barazisë që adresojnë gjuhën e urrejtjes. Bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm arriti rezultat të mirë me themelimin e "Aleancës Pa Urrejtje" dhe nënshkrimin e memorandumit, në të cilin disa fusha veprimi janë listuar. Pavarësisht sa më lart, mund të jepen rekomandimet vijuese:

- Miratimi sa më shpejtë i ndryshimeve në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi nga ana e Kuvendit.
- Ndryshimi i Kodit të Sjelljes së Deputetit në Parlamentit shqiptar, duke siguruar referencë specifike për gjuhën e urrejtjes dhe masat përkatëse disiplinore për deputetët.

¹⁰⁵ https://www.stonewall.org.uk/system/files/açess_to_justice_toolkit_albanian.pdf

- Roli i OSHC-ve duhet të forcohet më së shumti në ndihmën ndaj viktimave të gjuhës së urrejtjes dhe në rritjen e fluksit të informacionit dhe nivelit të ndërgjegjësimit midis komuniteteve lokale. Partneriteti me organet e barazisë është shumë i rëndësishëm. Bashkëpunimi duhet të përqendrohet në analiza dhe studime.
- Organet e barazisë duhet të përmirësojnë rolin që kanë në përmbushjen e plotë të mandatit të tyre ligjor. Të dhënat e studimeve dhe kërkimeve mbi situatën e gjuhës së urrejtjes, të cilat mungojnë për momentin, duhet të udhëheqin planet e veprimeve dhe aktiviteteteve të së ardhmes. Trajnimi i stafit është gjithashtu shumë i rëndësishëm. Publikimi i historive të suksesit gjithashtu mund të shërbejë për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit.
- Publikime të dedikuara dhe seksione në faqet e internetit të KMD-së, në mënyrë që informacionet mbi gjuhën e urrejtjes të aksesohet lehtësisht.
- Edukimi i fëmijëve dhe të rinjve për gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin por edhe përdorimi i informuar i mediave sociale është thelbësor nga këndvështrimi i ndryshimit kulturor që nevojitet, si dhe për raportimin dhe adresimin e përmirësuar të gjuhës së urrejtjes dhe rasteve të tjera diskriminuese. Kjo mund të arrihet lehtësisht përmes rishikimit të kurrikulave të lëndëve "Edukimi civil" në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin.
- Meqenëse gjuha e urrejtjes nuk është çështje vetëm e kryeqytetit/qendrës, ekziston nevoja për nxitjen e veprimeve në nivelin lokal përmes përfshirjes së gjerë të OSHC-ve, por edhe përmes krijimit të zyrave vendore të KMD dhe Avokatit të Popullit.
- Këshilli i Evropës duhet të mbështesë me trajnime dhe publikim të studimeve.
- Trajnimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve për gjuhën e urrejtjes, gjetjen e balancës ndërmjet gjuhës së urrejtjes dhe lirisë së shprehjes dhe rasteve të diskriminimit.
- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit përmes trajnimeve të mbajtura nga komuniteti ose edukimi i miqve dhe familjes për rreziqet e diskriminimit dhe intolerancës.
- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit për raportimin e gjuhës së urrejtjes online dhe promovimin e mekanizmave ku mund të raportohen postime të tilla.
- Nxitja e mesazheve pozitive të paqes dhe tolerancës në mediat sociale dhe platformat online.
- Mbajtja e seminareve rreth gazetarisë së ndjeshme ndaj konflikteve me qëllim mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve etike të gazetarëve në identifikimin e burimeve të konfliktit dhe raportimin e lajmeve në mënyrë të drejtë dhe të saktë.
- Formimi i komisioneve të paralajmërimit të hershëm dhe reagimit të hershëm në nivel kombëtar dhe lokal për të monitoruar gjuhën e urrejtjes dhe format e tjera të nxitjes së dhunës.

11 Referenca

KiE/ECRI CR(2000)21 Rekomandimi nr.15 i Politikës së Përgjithshme mbi Luftimin e Gjuhës së Urrëjtjes, i disponueshëm në <https://www.coe.int/en/ëeb/european-commission-against-racism-and-intolerance/home> (30.04.2020)

Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë mbi Komunikimin për Politikën e Zgjerimit të BE, 2019, i disponueshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf> (30.04.2020)

Paket e Zgjerimit të BE (2019) *Liria e Shprehjes dhe shoqëria e informacionit dhe medias 2019*, e disponueshme në ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement (30.04.2020)

Irion, K.; Cavaliere, P.; Pavli, D (2015) *Studim Krahasimor mbi Praktikrat më të Mira Evropiane të Rregullimit të Përmbajtjes online: rregullime politike dhe ligjore, veçanërisht shpifja online në këndvështrim të propozimeve legjislative në Shqipëri*, KiE, i disponueshëm në <https://hdl.handle.net/11245/1.493315> (30.04.2020)

S. Simoni, M. Xhaxho (2019) *Raport mbi Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit në Komunitet e Roskovecit dhe zonën rurale*, Qendra për Gruan, Komunitetin dhe Mjedisin i disponueshëm në www.qag-al.org (30.04.2020)

ECRI (2015) *Raport mbi Ciklin Monitorues të Pesëmbëdhjetë në Shqipëri* f. 19-20 i disponueshëm në: <https://www.coe.int/en/ëeb/european-commission-against-racism-and-intolerance/albania> (30.04.2020)

E.Toska (2018) Komiteti Shqiptar i Helsinkit *Raport studimor Për aksesin në drejtësi të grupeve vulnerabël*, at http://www.ahc.org.al/ëp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf (30.04.2020)

ECRI (2015) *Raport mbi Ciklin Monitorues të Pesëmbëdhjetë në Shqipëri* f. 19-20 i disponueshëm në: <https://www.coe.int/en/ëeb/european-commission-against-racism-and-intolerance/albania> (30.04.2020)

Raporti mbi Krimet e Urrejtjes, OSBE ODIHR, Shqipëri, Viti 2018, i disponueshëm në <https://hatecrime.osce.org/albania?year=2018> (14.04.2020)

Raport i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janar-qershor 2019, Faqja 36, i disponueshëm në <https://www.kmd.al/ëp-content/uploads/2020/02/Raport-KMD-Janar-Qershor-2019-perfundimtar.pdf> (kontrolluar më 07.04.2020);

Kuadri ligjor shqiptar:

Ligji nr.8417/1998 *Kushtetuta e Shqipërisë*

Ligji nr. 7895/1995 *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*

Ligji nr. 7850/1995 *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*

Ligji nr. 10 221, 04.02.2010 *Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*

Ligji nr. 8454/1999 *Për Avokatin e Popullit*

Ligji nr. 111/2017 *Për Ndhmën Ligjore*

Ligji nr.10018/2008 *Për Avokaturën e Shtetit*

Kodi i Etikës së Gazetarëve (2018)

Udhëzime etike për gazetarinë online (2018)

Shtojca 1 – Model për Shembuj të Praktikave më të Mira

Tabela 1:

Fusha ¹⁰⁶	Masat vetë-rregullatore
Titulli (gjuha origjinale)	Kuvendi i Shqipërisë Vendim nr.61/2018 Për Miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës Së Shqipërisë Kuvendi i Shqipërisë Vendim nr.19 /2018 Për Miratimin Udhëzuesit të Detajuar për Sjelljen në Kuvend
Titulli (Anglisht)	Albanian Parliament Decision no 61/2018 On the approval of code of conduct of Members of Parliament in the Republic of Albania Albanian Parliament Decision of Bureau of Assembly no.19 /2018 Detailed Guidelines on the Code of Conduct of MP
Organizata (gjuha origjinale) Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	Kuvendi i Shqipërisë
Organizata (Anglisht) Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	Albanian Parliament
Qeveria / Shoqëria Civile Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	
Linku në internet	www.parlament.al
Lloji i nismës	Kodi i Sjelljes (rregullat)
Grupi i targetuar kryesor	Politikebërësit
Përshkrim i shkurtër (maksimumi 1000 karaktere)	Kodi i Sjelljes së Deputetit bashkëngjitur Rregullave Procedurale të Kuvendit ndalon deputetët që të përdorin gjuhë nxitëse të urrejtjes dhe diskriminimit për shkaqe të fesë, gjinisë, bindjeve politike apo orientimeve seksuale. Kjo është thelluar më shumë në Udhëzuesin e Detajuar për Sjelljen në Kuvend i cili kërkon që deputetët e Kuvendit të shmangin çdo sjellje diskriminuese të fshehur apo të tërthortë për shkaqe racore, të orientimit seksual, të bindjeve dhe të çdo çështje tjetër. Deputetët do të jenë subjekte të masave disiplinore të rënda në rast të përdorimit të gjuhës diskriminuese dhe fyese për shkaqe të tilla si raca, gjinia, bindjet politike dhe orientimet seksuale.

¹⁰⁶ Specifikoni nëse nisma është ndërmarrë në fushën e legjislacionit, kuadrit institucional, sipas rolit të organeve të barazisë, çështjeve të paraqitura, bashkëpunimit mes palëve të interesuara përkatëse, masave për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, studimeve dhe sondazheve apo projekteve.

Vlerësimi ose kontrolli i cilësisë	<input checked="" type="checkbox"/> jo <input type="checkbox"/> po si?		
Përfshirja e palëve të interesuara	<input checked="" type="checkbox"/> jo <input type="checkbox"/> po kush dhe si?		
Pse praktika e mirë?	<input type="checkbox"/> mbi standardet BE/ndërkombëtare <input type="checkbox"/> novacioni	<input checked="" type="checkbox"/> efektiviteti dhe impakti <input type="checkbox"/> qëndrueshmëria	<input type="checkbox"/> transferueshmëria

Tabela 2:

Fusha¹⁰⁷	Bashkëpunimi me pakët e interesuara përkatëse
Titulli (gjuha origjinale)	Aleanca Pa Urrejtje
Titulli (Anglisht)	No Hate Alliance
Organizata (gjuha origjinale) Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	
Organizata (Anglisht) Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	Avokati i Popullit; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Autoriteti i Medias Audiovizive dhe Këshilli Shqiptar i Medias, KiE/BE "Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri" dhe Projekti mbi "Lirinë e Shprehjes dhe Medias" (JUFREX)
Qeveria / Shoqëria Civile Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	
Linku në internet	https://www.coe.int/en/ëeb/tirana/-/-no-hate-alliance-a-joint-approach-against-discrimination-and-hate-speech
Lloji i nismës	Informacione, fushata, studime, sondazhe, etj.
Grupi i targetuar kryesor	Publik i përgjithshëm, viktimat potenciale të anti-diskriminimit, të rinjtë.

¹⁰⁷ Specifikoni nëse nisma është ndërmarrë në fushën e legjislacionit, kuadrit institucional, sipas rolit të organeve të barazisë, çështjeve të paraqitura, bashkëpunimit mes palëve të interesuara përkatëse, masave për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, studimeve dhe sondazheve apo projekteve.

Përshkrim i shkurtër (maksimumi 1000 karaktere)	“Aleanca Pa Urrejtje” e cila përfaqëson një qasje të përbashkët në promovimin e diversitetit dhe luftën e gjuhën së urrejtjes në Shqipëri. Aleanca do të zhvillojë materiale komunikimi dhe informacione për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe promovimin e diversitetit, lirisë së shprehjes me anë të broshurave, raporteve, fushatave e PSA, etj., për të arritur audiencën e saj por dhe shoqërinë më gjerë; do të forcojë bashkëpunimin me organizata dhe agjenci të tjera partnere strategjike që kanë një rol të rëndësishëm në luftën kundër diskriminimit siç janë Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve, ofruesit e shërbimeve të Internetit (ISP), organizatat e gazetareve, organizatat e shoqërisë civile, organizatat e mbrojtjes së konsumatorit, etj; do të mbështesë partnerët në identifikimin e mekanizmeve efektive për të luftuar gjuhën e urrejtjes bazuar në praktikatat më të mira evropiane; do të identifikojë mekanizmat për rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe trajnimit të personelit.		
Vlerësimi ose kontrolli i cilësisë	X jo <input type="checkbox"/> po si?		
Përfshirja e palëve të interesuara	<input type="checkbox"/> jo X po kush? KMD, Avokati i Popullit, Këshilli Shqiptar i Medias, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe si? Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit		
Pse praktika e mirë?	<input type="checkbox"/> mbi standardet BE/ndërkombëtare <input type="checkbox"/> novacioni	<input type="checkbox"/> efektiviteti dhe impakti X qëndrueshmëria	<input type="checkbox"/> transferueshmëria

Tabela 3:

Fusha¹⁰⁸	Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit
Titulli (gjuha origjinale)	Mekanizmi i monitorimit
Titulli (Anglisht)	Monitoring mechanism
Organizata (gjuha origjinale) Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	Këshilli Shqiptar i Medias
Organizata (Anglisht) Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	Albanian Media Council

¹⁰⁸ Specifikoni nëse nisma është ndërmarrë në fushën e legjislacionit, kuadrit institucional, sipas rolit të organeve të barazisë, çështjeve të paraqitura, bashkëpunimit mes palëve të interesuara përkatëse, masave për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, studimeve dhe sondazheve apo projekteve.

Qeveria / Shoqëria Civile Përgjegjës për zbatimin Përgjegjës për financimin	
Linku në internet	https://kshm.al/en/complaints/file-a-complaint/
Lloji i nismës	Mekanizmi i monitorimit
Grupi i targetuar kryesor	p.sh. publiku i gjerë, viktimat potenciale të diskriminimit, gazetarët, hapësirat mediatike
Përshkrim i shkurtër (maksimumi 1000 karaktere)	Këshilli Shqiptar i Medias ka krijuar një bazë të dhënash online me shkeljet e kodit të etikës. Baza e të dhënave do të përmbajë gjetjet nga një proces monitorimi që po vazhdon brenda Këshillit Shqiptar të Medias që prej një vit. Qëllimi është të rritet ndërgjegjësimi i publikut për numrin e madh të shkeljeve të kodit të etikës nga Media shqiptare dhe për faktin se vetë-rregullimi funksionon vetëm nëse publiku është i përfshirë në mënyrë aktive në këtë proces. Publiku mund të ketë qasje në bazën e të dhënave përmes një sistemi kërkimi që siguron kategori sipas neneve të Kodit të Etikës dhe Gjuha e Urrejtjes është një prej tyre. Bordi i Ankesave shërben si një alternative ndaj gjykatës.
Vlerësimi ose kontrolli i cilësisë	<input checked="" type="checkbox"/> jo <input type="checkbox"/> po si?
Përfshirja e palëve të interesuara	<input checked="" type="checkbox"/> jo <input type="checkbox"/> po kush ? dhe si?
Pse praktika e mirë?	<input type="checkbox"/> mbi standardet BE/ndërkombëtare <input checked="" type="checkbox"/> novacioni <input type="checkbox"/> efektiviteti dhe impakti <input type="checkbox"/> qëndrueshmëria <input type="checkbox"/> transferueshmëria

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të asnjë pale.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe